



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

6581

Dt 26.09.2025

Librazhd më: 25.09.2025

NJOFTIM

“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”

Z.znj. _____

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Martë, datë 30.09.2025**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Shtator** 2025. Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.08.2025 dhe procesverbalin e mbledhjes 04.09.2025
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha gusht 2025”.
4. **P/Vendim** “ Për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit në Bashkinë Librazhd”.
5. **P/Vendim** “ Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2025”.
6. **P/Vendim** “ Ndërtim bazamente për urë tip “Baily” HD 30 ML me seksion 1/1 Njësia Administrative Orenjë Bashkia Librazhd”.
7. **P/Vendim** “Mbështetje financiare për përballimin e fatkeqësisë së krijuar nga zjarri për bashkinë Gramsh”.
8. **P/Vendim** “Përdorim fondi reserve për prodhim,transport,ngarkim,pastrim,strivim material drusor në ekonominë pyjore Dardhë-Xhyrë dhe Neshtë-Prevallë.
9. **P/Vendim** “Për dhënie ndihme financiare”.
10. **P/Vendim** “ Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë”.
11. **P/Vendim** “ Për miratimin e Kalendarit të Kosultimeve Publike”
12. **Të ndryshme:**

- *Ditën e hënë datë 29.09.2025 ora 10:00 të mbledhen Komisionet te Salla e Këshillit Bashkiak.*

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BLOKU



PROCEVERBAL

- I mbajtur sot më datë 29.08.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 12 vota pro.
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 29.07.2025 me 10 vota pro dhe 2 kundër nga këshilltarët e pranishëm. Këshilltari Bledi Koçi propozoj që tek pjesa e votimit të shkruhen me erma votat.
- Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.07.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha korrik 2025”.
4. **P/Vendim** “ Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 ,VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
5. **P/Vendim** “ Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 ,VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
6. **P/Vendim** “Për miratimin e marrveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njërive të vetqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA).
7. **Të ndryshme:**
 - 1.**P/Vendim** “Për miratimin e varrezave publike të lagjes Balliu, në pasurinë Nr.133/28, Zk 1652 Nj. Ad. Orenjë, Bashkia Librazhd.
 - 2.**P/Vendim** “Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë.
 - 3.**P/Vendim** “Për përfshirjen në listën e familjeve që përfitojnë nga programi I strehimit.
 - 4.**P/Vendim** “Për miratimin e Planit të Integritetit”.
 - 5.**P/Vendim** “Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit parashkollor në Bashkinë Librazhd.

Fillimi I mbledhjes:

P/Vendimi nr 1 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha korrik 2025”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **13 vota pro**. Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku. (Këshilltarët e pranishëm).

2.P/Vendim“Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027 , VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Sa ka qënë kontrata për furnizimin me mish për kopshtet dhe çerdhen?

Si ka mundesi që kjo vlerë kaq e madhe të teprojë? Të kursesh lekë dhe për feminjet e kopshteve dhe çerdheve më duket diçka shumë e rëndë, biles për këtë gjë duhet ngritur zëri nga të gjithë këshilltarët.

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Unë mendoj që ju duhet të na falenderoni që kemi kursyr lekë, pasi ne funizimin për kopshtet dhe çerdhen e bëjmë në mënyrë të rregullt dhe besoj se të gjithë ju e deni që ne kushtet I kemi të mira dhe ushqimi preferohet nga feminjët, tani varet sa feminje konsumojnë ushqimin dhe ne patjeter që pjesa që ngel nuk do ta hedhim por duhet ta kursejmë fondin për diçka tjetër. Është marrveshje kuadër dhe biem dakort me operatorin.

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.

Unë jam pro këtij vendimi dhe shumë mire që po kaloni shtesë për pagat për Policinë Bashkiake por kam një vrejtje për Policinë Bashkiake, në xhirot e darkës nuk shikoj asnjë nga Policet e turnit, ku kalojne me biçikleta me shpejtësi, luajn me top para bashkisë, duhen marre masa sa me shpejt.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Shikoj që keni hequr fondin për shkollën e Lunikut? A në këtë kohë menduat tja hiqni fondin shkollës së Lunikut?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Shkolla e Lunikut ka qënë që të behet nëpërmjet bashkëfinancimit me Këshillin e Qarkut, por ne momentin që kemi pasur diskutime me Këshillin e Qarku kemi pasur dhe disa donatorë të huaj dhe menduam që kë fonde ti përdorim për diku tjetër dhe shkollën e Lunikut ta bëjmë njëher e mire.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 11 vota pro dhe 3 vota kundër.

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku.

Votat kundër: Bledi Koçi, Veli Terziu, Ilir Kuka.

3. P/Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027, VKB nr 3 datë 31.01.2025 për një shtesë në v.k.b nr 108 datë 27.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2025-2027”.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Në lidhje me këto lera betoni kur bëni pakësim fondi thoni pakësojmë me vlerë 6 milion leke dhe kur beni shtim fondi e beni 12 milion leke.

A mund të behet një lerë betoni me 6 milion lekë? A është i mjaftueshëm ky fond?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Ne kemi filluar që keto lerat ti bejme me fuqin puntore që ne kemi dhe nuk i bejme tja japim firmës private dhe kshu kursejmë më shumë fonde.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku, Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku, Bledi Koçi, Veli Terziu, Ilir Kuka.

4. P/Vendim “Për miratimin e marrveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kopetencave të përbashkëta midis njësive të vetqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për nritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA).

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në lidhje me këtë p/vendim na ka ardhur një udhezim nga Ministria ku do të ngrihet Akademia e trajnimit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë(TALGA).Ku do kete trajnim per punonjesit e Administrates dhe nje per ju Keshilltarët,mendoj se eshte nje gje shume e mire për të gjithë ne.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me **të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Flutur Kojku ,Fiqirete Alliu,Arjana Çekrezi,Arben Hoxha,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Habil Biçaku,Bledi Koçi,Illir Kuka.

5.P/Vendim“Për miratimin e varrezave publike të lagjes Balliu,në pasurinë Nr.133/28,Zk 1652 Nj.Ad. Orenjë,Bashkia Librazhd.

Këshilltari Ilir Kuka e merr fjalën:

Në lidhje me kë p/vendim unë jam në djeni pasi jam dhe banori I asaj zone,bëhet fjalë për dy familje ku kanë pasur sherre here pas here dhe tani lagjia e Balliut kërkon që këto varreza ti bëjnë të fisit të tyre, une jam kundër ketij P/Vendimi.

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.

Dhe une I njoh këto dy familje dhe më e mira është që keto dy familje mos ken sherre me njëra tjetrën por të gjihet një rrugesgjdhje.

Këshilltari Bujar Vreto e merr fjalën.

I njoh shumë keto dy familje dhe di që varreza janë shumë të vjetra në fshat ,e mira është që mos të ketë diskutime lur bëhet fjalë për varreza.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 11 vota pro dhe 1 kundër.

Votat pro: Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Flutur Kojku ,Fiqirete Alliu,Arjana Çekrezi,Arben Hoxha,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Habil Biçaku.

Votat kundë: Ilir Kuka.

6.P/Vendim ““Për miratimin e Planit të Integritetit”.

Nuk ka pyetje nga Këshillatrët

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **12 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Flutur Kojku ,Fiqirete Alliu,Arjana Çekrezi,Arben Hoxha,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Bujar Vreto,Habil Biçaku,Illir Kuka.

7.P/Vendimi “Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit parashkollor në Bashkinë Librazhd.

Nuk ka pyetje nga Këshillatrët

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **12 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku , Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Bujar Vreto, Habil Biçaku.

8.P/Vendim “Për përfshirjen në listën e familjeve që përfitojnë nga programi I strehimit.

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në këtë rast kemi një familje që ka bërë një kërkesë që ta përfshijmë në listën e familjeve që përfitojnë nga programi I strehimit.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **11 vota pro.**

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku , Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Habil Biçaku, Ilir Kuka.

9.P/Vendim “Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë.

Përgjegjësi i zyrës tek Sektori I Menaxhimit të Tokave Bujqësore ,Albert Alla e merr fjalën të na sqaroj në lidhje me këtë P/vendim.

Bashkia ka interes për ti dhene me qira keto toka bujqësore pasi kjo nxit punësimin dhe zhvillimin e zones si dhe siguron te ardhura ne favor te saj.Parcelat që kërkohej të jepen me qira ndodhen ne zonen kadastrale 1715,fshati Gizavesh me nje siperfaqe totale pre 2.5236 ha në të cilen perfshihen pasurite nr.199/7,nr.201/2 nr.201/10 dhe nr 202.Procedurat do te ndiqen sipas udhëzimit nr.1 datë.18.07.2012 “Për procedurat e dhenies me qira te tokave bujqesore të pandara.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **12 vota pro.**

(Por që ky p/vendim të kaloj në vendim duhet që të votohet nga 3/5 e keshilltarëve, nuk kalon ky p/vendim pasi nuk plotesohet korumi I nevojshëm

Votat pro: Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Flutur Kojku , Fiqirete Alliu, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Habil Biçaku, Ilir Kuka, Bujar Vreto.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elson MALLUTA



KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU



PROCEVERBAL


- I mbajtur sot më datë 04.09.2025 në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Librazhd.
 - Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 16 vota pro.
 - Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:
1. P/Vendim "Për miratimin e rregullores për Administrimin dhe Monitorimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Librazhd.

Morën pjesë në votim: Arjana Çekrezi, Mitat Biçaku, Silvana Hoxha, Erjola Albrahimi, Adelina Alla, Elidjona Bahiti, Fiqirete Alliu, Ndriçim Doda, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Zenel Bahiti, Kujtim Albrahimi, Dashnor Hysa, Ilir Kuka, Fatbardha Qatja, Habil Biçaku.

- Miratohet ky p/vendim me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota pro.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elson MALLUTA



KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

PROJEKT-VENDIM

Nr.21 Datë 16.09.2025

Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike
nga fondi i Kushtëzuar 6%
(Periudha: GUSHT 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”

Nisur sa më lart nga verifikimi i sistemit elektronik i Ndhmës Ekonomike rezulton se janë refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) 77 Familje, dhe propozohet:

- 1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6%: Gjithsej 77 Familje me një fond: **313,329** lekë. Vlera e ndihmës **248,929** lekë, vlera e energjisë **64,400** lekë
- 2-Të mos përfitojnë për arsye të mos plotësimit të kriterëve nga fondi i kushtëzuar 6% nuk ka familje.
- 3-Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.
- 4-Ngarkohen për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi Administratorët Shoqërorë të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative.
- 5- Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së Vendimit

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka

**KRYETARI I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

RELACION

Nr.21 datë 16.09.2025

Mbi Dhënien e Ndhmës Ekonomike
nga Fondi i Kushtëzuar 6%
(Periudha: GUSHT 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” përcaktohet qarte se kush mund ta përfitojë kete ndihme nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike.

E rëndësishme është që familjet që nuk klasifikohen si përfituse në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike me pikë të pa mjaftushme të verifikohen saktësisht nga Administratori Shoqërorë i Ndhmës Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike, sociale, shoqërore dhe duke pasur parasysh kriteret që janë miratuar në Këshillin Bashkiak ta vlersojë familjen nëse duhet apo jo që të klasifikohet si familje që duhet të përfitojë ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik ne familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 77 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 77 familje.

2- Te mos përfitojne nuk ka familje.

Njesitë Administrative:

1. Njësia Administrative Qytet	31 Familje me fond	126,244 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	13 Familje me fond	59,865 lekë
3. Njësia Administrative Polis	9 Familje me fond	33,505 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	15 Familje me fond	57,996 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	9 Familje me fond	35,719 lekë

Totali si Bashki 77 familje me fond 313,329 lekë.


Relacion për Familjet e Refuzuara

- Familjet që nuk janë rekomanduar për tu trajtuar nga fondi 6 % nuk ka.

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka





FONDI 6%

Periudha: GUSHT 2025

Bashkia Librazhd

Nr	Emri i Aplikantit	NID	Statusi aplikimit	Vlera e përlogaritur për fondin 6%		Kompensimi i Energjisë	Totali	Numri anëtarëve	
1	Kujtim Ymerli Polisi	H00409064A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		1,288	4,991	3	
2	Rabie Sadik Leka	G95628010G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		1,288	3,466	1	
3	Muhamet Qazim Gega	G50501112O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		1,288	4,991	2	
4	Ymer Xhafer Kala	G31020023L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		1,288	4,337	3	
5	Avni Reshit Stafa	H20620213J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		1,288	3,466	1	
6	Jonuz Shahin Çota	G30206013H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703			3,703	3	
7	Sabri Hajdar Stafa	G71012046N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		1,288	4,991	2	
8	Lutfije Ali Roçi	E25406026F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		1,288	4,434	1	
9	Avni Beqir Bogdani	H00106009U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227		1,288	6,515	3	
10	Xhemile Xhelo Alliu	G75616178K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		1,288	4,991	2	
11	Vera Mehmet Dada	I75404018N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		1,288	3,466	1	
12	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		1,288	4,434	1	
13	Eduart Xhevit Pali	I10524158W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,792		1,288	6,080	4	
13	Total Njësia Administrative: Hotolisht			44,409		15,456	59,865	27	
1	Shyqyrije Qazim Shpata	D66211004W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049			3,049	2	
2	Artur Musa Agastra	G10101021O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		1,288	3,466	1	
3	Shyqyrie Belul Blloshmi	G65107079J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		1,288	4,991	2	
4	Tahire Qamil Balla	G35812017F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		1,288	4,434	1	
5	Vule Kadri Topi	F75710021A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146			3,146	1	
6	Farije Sefedin Topi	G05328025M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146			3,146	1	
7	Qamil Selman Ferra	F80501032B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		1,288	4,434	1	
8	Olsi Nazmi Dosku	H50108018L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178			2,178	1	
9	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146			3,146	1	

10	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
11	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
12	Leonard Enver Brasha	J60806018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
13	Piro Ferit Halili	H70320023A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
14	Arjan Mevlut Meta	I20327028C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
15	Nasibe Ismail Hunçi	G45229211O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
16	Artur Isuf Guga	G80721009F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
17	Lulzim Dylber Kazazi	G30612046C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
18	Alma Nexhat Kola	G45703011C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
19	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
20	Bule Myhedin Kojku	H55125015N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7,920	1,288	9,208	3
21	Irena Agim Balazi	I65427026D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,980	1,288	3,268	2
22	Mirjana Abdulla Çollaku	G76014110Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
23	Fatmira Beqir Hysa	H70522017S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
24	Qanije Refat Brasha	F95520031H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
25	Xhevahire Haziz Biçaku	G45120093D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
26	Sabije Livan Zyka	F66018008Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,720	1,288	7,008	1
27	Ramazan Tahir Brahja	G10225030V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
28	Ardi Osman Elezi	I61115008U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
29	Bujar Bajram Bahidi	G80316015M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
30	Albert Refat Brahja	I60413014P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,267		3,267	2
31	Lulzime Nebi Roçi	J55223019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	3
31	Total Njësia Administrative: Librazhd			101,772	24,472	126,244	48
1	Dashurije Islam Kiçi	F85303158B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
2	Ismet Shaip Balliu	F61209003T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	6,752	1,288	8,040	4
3	Nazif Mehmet Qostja	F90730127I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
4	Bashkim Reshit Biba	G70701144N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
5	Nazmi Liman Ruçi	E60228033R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525		1,525	3
6	Kadife Abaz Balliu	G15710021S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
7	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,158	1,288	5,446	3
8	Zanushe Shefqet Haskurti	G76003005L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
9	Nadire Maksut Luka	E85901096E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	Total Njësia Administrative: Orenje			29,279	6,440	35,719	19

1	Sadik Riza Zaimi	G30325115M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Afërdita Rexhep Tanushi	G46125056D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
3	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,752		4,752	2
4	Xhevahire Islam Zaimi	G95321059Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
5	Sabrie Sadik Shata	G95605100F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
6	Mexhit Nuredin Stërmugu	F90224131N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
7	Hava Hamit Hasani	G65823039B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
8	Nadire Mustafa Kasa	H26223016N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	3
9	Xhevrije Shahin Xhakeri	G65325034C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
9	Total Njësia Administrative: Polis			27,065	6,440	33,505	14
1	Fatmir Kadri Hoxha	G40320186W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
2	Serme Kamer Qoshku	G65702019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
3	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
4	Sanije Shefqet Alija	G65125222I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
6	Ymer Tafil Alla	G10625082P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
7	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
8	Trandafille Sulejman Çela	H05505324G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
9	Suzana Ramazan Almina	J45904016K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
10	Xhane Osman Kojku	G65105008W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
11	Sanie Qamil Hoxha	G15614006P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
12	Gani Bajram Faqolli	G40720092D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
13	Sabire Xhemal Shuli	A55716002R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
14	Fiqirete Ymer Rruplli	H85916021Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
15	Flamur Osman Dosku	G30729006Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
15	Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZHD			46,404	11,592	57,996	20
77	Totali Bashkisë			248,929	64,400	313,329	128

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____._____. 2025

**"PËR SHPALLJEN E ZONAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË BASHKINË
LIBRAZHD"**

Këshilli i Bashkisë Librazhd, bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, Ligjin nr.20/2025 "Për paketën e maleve", Udhëzimin nr.1, datë 19.06.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive" në mbledhjen e datës _____._____.2025 të :

V E N D O S I

1. Të miratojë shpalljen e disa zonave zhvillimore në Njësitë Administrative **Qendër, Stëbleve, Hotolisht, Polis, Orenjë dhe Lunik** si zona prioritare të zhvillimit në territorin e **Bashkisë Librazhd;**
2. Të miratojë **dokumentacionin** shoqërues si më poshtë:
 - a) Projektaktin e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të punës;
 - b) Relacionin shoqërues, hartuar në përputhje me parashikimet e pikës 4, të këtij udhëzimi, që evidenton përmbushjen e të gjitha detyrave të grupit të punës.
 - c) Hartën e zonës së propozuar, sipas sistemit KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto (manual dhe digjital);
 - d) Hartën e zonës së propozuar, të pasuruar me informacionin kadastral (manual dhe digjital);
 - e) Hartën e zonës së propozuar, të pasuruar me informacionin e Planit të Përgjithshëm Vendor (manual dhe digjital);
 - f) Listën e aktiviteteve të mundshme/të synuara për zhvillim, bazuar në analizën e sektorëve me prioritet;
 - g) Dokumentacion që provon realizimin e konsultimeve paraprake me komunitetin lokal dhe palët e interesuara;
 - h) Të dhëna mbi praninë e poseduesve jopronarë brenda zonës së propozuar, statusin ligjor dhe kategorinë (klasifikimin) e pronës;
 - i) Raport mbi infrastrukturën ekzistuese dhe nevojat për investime infrastrukturore.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, grupi i punës dhe administrata e Bashkisë Librazhd;

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6 .

Bajram Pishkashi – Sekretar i Përgjithshëm



**KRYETAR I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**

➤ **Të dhëna mbi praninë e poseduesve jopronarë Brenda zonës së propozuar.**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, të nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”,nenit 17 e vijues të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” të ndryshuar, VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të pyjeve dhe të kullotave publike,sipas listës të inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar,***bashkia Librazhd është pronar të listës së ngastrës sipas shtojcs 18.*** Lista e ngastrave e kaluar në pronësi të bashkisë ,ku është kryer dhe regjistrimi fillestar i tyre dhe jemi në fazën ku po tërheqim çertifikatat e pronësisë për cdo ngastër të fondit pyjor/kullosor me pronar bashkinë Librazhd.

Bazuar në potencialin turistik që gjendet në territorin e bashkisë Librazhd si dhe bazuar në Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik” nëpërmjet ankandin publik janë dhënë sipërfaqe për krijimin e ambjenteve akomoduese dhe turistike me afat 9- vjeçar. Sipërfaqet e dhena për zhvillimin e turizmit kanë patur si objekt :

- a) Shfrytëzmin e mundësisë së potencialit turistik që bashkia Librazhd ka pa dëmtuar mjedisin për zhvillimin e turizmit malor,ambjenteve akomoduese për turistët.
- b) Promovimi i qytetit dhe një prej parqeve më të mëdhenj të Shqipërisë ,atij të Shebenikut.
- c) Rritja e të ardhurave në buxhetin e bashkisë Librazhd.

Theksojmë se këto kontrata të nënshkruara janë në monitorim nga strukturat përgjegjëse në bashki në mënyrë që ajo të respektohet në mënyrën më rigoroze dhe brenda kuadrit ligjor po dhe synimit për të cilën është nënshkruar kontrata.

Aktualisht në zonat prioritare që ne propozojmë të shpallen ndodhen 22 kontrata qiraje për zhvillimin e veprimtarive turistike me një sipërfaqe totale 22.23 ha. Subjektet apo personat që kanë nënshkruar këto kontrata janë posedues jopronarë me një afat 9-vjeçar.

➤ TURIZMI DHE TRASHËGIMIT KULTURORE

Bashkia Librazhd me 7 Njësi Administrative dhe 52 fshatra, ndodhet në një pozitë gjeografike mjaft të favorshme ku në çdo fshat dhe lagje është mundësia për shndërrim në atraksion turistik. Bazuar në "Strategjia e zhvillimit të territorit Librazhd dhe Prrenjas të 2017" rezulton se në gjithë bashkinë Librazhd ka:

- a) 138,882 ha zona të rëndësisë kombëtare dhe zona të mbrojtura,
- b) 26 monumente natyrore,
- c) 15 monumente kulturore dhe
- d) 35 km rrugë Egnatia.

Referuar informacioneve zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Rrjetit të Zonave të Mbrojtura të vitit 2014të përgatitur nga Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura, sektori i zonave të mbrojtura në territorin e bashkisë së re Librazhd përfshin:

- ❖ -Parku Kombëtar Shebenik - Jabllanice, kategoria II, me sipërfaqe 33,927.7 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.640, datë 21.05.2008;
- ❖ Parku Natyror Rajonal Kuturman, kategoria IV, me sipërfaqe 3,600 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri shpallur me Rreg. MB nr.1, datë 27.7.1977;
- ❖ Parku Natyror Rajonal Polis, kategoria IV, me sip. 45.0 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996;
- ❖ Parku Natyror Rajonal Sopot, kategoria IV, me sip. 300 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996;
- ❖ Parku Natyror Rajonal Dardhë - Xhyrë, kategoria IV, me sip. 400 ha - pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996.

Diversiteti natyror në parqe dhe përreth tyre është shumë i pasur, si për nga flora ashtu edhe nga fauna. Parqet kanë drurë ahu, pishë e zezë, bredh, lis, mështekna, arneni, bush, ajdes, panjë, shëlg, lajthi, shkozë, mëllezë, vidh, vodhëz të egër, qersh të egër, boronicë, gorricë, dardha të egër, trëndafil të egër, çaji i mali, sanza dhe më i rralli, endemiku ylli i alpeve, etj. Speciet kryesore të faunës janë: ariu i murrmë, ujku, vjedulla, dhelpra, ketri, nusja e lalës, shqiponja, skifteri, etj. Më të rrallë janë: zardafi, Treva numëron edhe 26 monumente të tjera natyrore, të listuara si të kategorisë së parë. Përmendin rrugën Egnatia, Kishën e Koshorishtit, ndërtuar në një shpellë në shek. II para erës sonë; dhe distancën e shkurtër nga zona të tjera me rëndësi arkeologjike. Librazhdi është pjesë e rrugëtimeve të turizmit historik. Zona ka kapacitete shumë të favorshme për turizëm malor.


Zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit. Ka ndërtimet karakteristike si psh. fshati Llangë me shtëpi karakteristike me mure guri, trekatëshe, shumëvjeçare; liqenet karstike Shebenik, liqenin e Fushë Studnes, Vlaskën, fushën e

Dorëzit, Bredhin e Fushë Kuqes, Rrapin e Taksimit, Shkallën e Skënderbeut, Gurrën e Ariut, e shumë të tjera. Afërsia ndaj rrugës kombëtare dhe tradita prodhuese janë mundësi të zhvillimit të zonës. Megjithë këto resurse turizmi në zonë akoma është në fazat e para të zhvillimit. Vizitorët janë të pakët dhe të vetëorganizuar..

Në vazhdimësi Bashkia Librazhd ka qënë në përpjekje për të shfrytëzuar mundësitë dhe minimizuar risqet dhe zhvillimi i turizmit në zonë është përgjigja, arsye për të cilën organograma e bashkisë tashmë përmban strukturë dhe drejtori specifike për turizmin. Strukturë e cila duke qënë në hapat e para është në nevojë për mbështetje në ngritje kapacitetesh dhe mjete logjistike që do ti vijnë në ndihmë zbatimit të planeve të punës me fokus prezencën në komunitet dhe shndërrimin e kësaj strukture në institucione të pështatshme dhe shërbime këshillimore të plota. Komuniteti, familje për familje, të rinjtë kanë nevojë për informim, ndërgjegjësim, këshillim dhe trajnim se si mund të shfrytëzojnë mundësitë dhe të minimizojnë riskun më të madh, atë të emigrimit, dhe fuqizimi i strukturave të posaçme për ta bërë këtë dhe rritur bashkëpunimin mes banorëve dhe bashkisë është zgjidhja më afatgjatë dhe që ofron qëndrueshmëri.

Prandaj ky projekt vjen i domosdoshëm për të shënuar ndryshimin dhe kthimin e bashkëpunimit komunitet dhe institucione në pikën më të fortë për zhvillimin e zonës dhe rritjen e të ardhurave nga turizmi, veçanërisht ai me bazë në komunitet.

➤ LISTA E AKTIVITETEVE TË MUNDSHME PËR ZHVILLIM



AKTIVITETE QE MUND TE ZHVILLOHEN NË NJËSINË ADMINISTRATIVE POLIS

1. Ecje Malore (Hiking) dhe Trekking

Itinerare të organizuara përgjatë shpatit të malit të Polisit, me pamje mbresëlënëse.
Shtegëtime përgjatë traseve të Via Egnatia – eksplorim historik dhe natyror.
Ecje deri në majat e larta panoramike, si Mali i Polisë apo rrënojat e vjetra të kullave e kalave.

2. Guidat Kulturore-Historike

Vizita të udhëzuara tek urat e lashta dhe rrënojat e rrugës së vjetër romake (Via Egnatia).

3.Kamping

Zona të përshtatshme për kamping buzë lumit, në afërsi të urave të lashta.

4. Rikonstruktimi i itinerareve të Via Egnatia për vizitorë

5. Rafting dhe Eksplorim Lumi Shkumbin

Sipas rrjedhës së lumit dhe sigurisë, organizim aktiviteteve si: kajakë, rafting, ose larje në burime natyrore.

6. Turizëm Kulinar e Tradicional

Eksperiencë në fshat me ushqime tradicionale të zonës, përgatitje bukë, djathi, apo gatime me produkte natyrore të malit.

AKTIVITETE QE MUND TE ZHVILLOHEN NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDËR

1. Ecje malore (hiking) në Parkun Kombëtar Shebenik
2. Kamping me tenda në zonat alpine të parkut
3. Eksplorim i liqeneve akullnajore të Shebenikut
4. Ngjitje në majën e Malit të Shebenikut
5. Vëzhgim i faunës së mbrojtur (linx, arinj, shqiponja)
6. Ecje përgjatë dhe Peshkim ne Lumin e Rrapunit
7. Vizitë në Rrapin e Taksimit (monument natyror dhe historik)
8. Vizita kulturore në fshatrat Qarrishtë, Dragostunjë, Dorëz
9. Degustim produktesh bio dhe tradicionale (mjaltë, çaj, bulmet, patate)
10. Aktivitetet e bletarisë dhe përpunimit të mjaltit
11. Festivale lokale (Festa e Qarrishtes, etj.)
12. Biçikletë malore (MTB) në shtigjet e parkut
13. Ekskursionet familjare dhe piknik në zona të shënuara

AKTIVITETE QE MUND TE ZHVILLOHEN NË NJËSINË ADMINISTRATIVE LUNIK

1. Caving & Hiking në Shpellën e Akullit

Eksplorim i shpellës së Akullit, një formacion gjeologjik unik për aktivitetin speleologjik (caving) dhe aventurë.

2. Hiking në Shpellën Eremite të Koshorishtit

Ecje malore drejt shpellës ku sipas traditës ka qëndruar një eremit i lashtë – destinacion për turizëm shpirtëror dhe historik.

3. Ecje Malore në Malin e Lunikut

Rruga drejt majës së malit të Lunikut ofron një eksperiencë të bukur hiking-u panoramik, e përshtatshme për grupe, të rinj dhe alpinistë.

4. Mulliri i Lunikut – Turizëm Tradite

Vizitë në mullirin e vjetër të Lunikut, ku turistët mund të përjetojnë procesin tradicional të bluarjes së grurit apo misrit.

5. Peshkim në Lumin e Lunikut

Zona të përshtatshme për peshkim sportiv dhe relaksues në ujërat e pastra të lumit.

6. Agroturizëm në fshatrat Prevall dhe Kostenjë

Mikpritje në shtëpi tradicionale, ushqime bio, përfshirë bulmet, reçel, çajra, verë e raki vendi. Përvojë me punët bujqësore, bletari, mbledhje të produkteve të pyllit dhe gatim lokal.

7. Blegtori dhe Jetë Alpine në Fushën e Letmit

Zonë ideale për blegtori sezonale dhe ngritje të staneve tradicionale të verës. Potencial për kampe verore me nxënës dhe studentë, aktivitete kulturore dhe edukative.

AKTIVITETE QE MUND TE ZHVILLOHEN NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ORENJË

1. Agroturizëm dhe Turizëm Rural

Vizita në ferma tradicionale për të përjetuar jetesën e përditshme të banorëve vendas.
Mikpritje në shtëpi pritëse tradicionale, me gatime vendase dhe traditë të pasur kulturore.

2. Eksplorim i Liqenit të Floqit

Ecje dhe piknik përgjatë brigjeve të liqenit, ideal për pushim dhe relaks.
Fotografi natyrore dhe vërtetim i faunës – liqeni ofron një peizazh të qetë dhe bukuri natyrore për adhuruesit e natyrës.
Kajak për vizitorët më aventurierë.

3. Vizitë në Shtëpitë e Vjetra Tradicionale

Shëtitje kulturore në fshatrat me arkitekturë karakteristike të zonës, ku ruhen elementë të ndërtimit të gurit dhe drurit.



4. Hiking dhe Eksplorim në Gurin e Muzhaqit

Ngjitje dhe ecje në natyrë drejt Gurit të Muzhaqit, një nga pikat dominuese malore të zonës.

**➤ DOKUMENTACIONIN QË PROVON REALIZIMIN E
KONSULTIMEVE PARAPRAKE ME KOMUNITETIN LOKAL
DHE PALËT E INTERESUAR**

LISTË PJESMARRJE
DËGJESË PAKETA E MALEVE

Polis, më 29/07/2025

Nr	Emër/Mbiemër	Institucion, Oj, Banor, Fermer	Telefon	Firmë
1	Et'vina Kosi	Administratore	0682167575	
2	Myslim Skodi	Kryeplok / Banor	0693994150	
3	ANDREA KAFASI	Kryeplok / banor	0684196 777	
4	Hason Stërmirja	Banor	0682321756	
5	Jaho Zherri	Kryeplok/banor	0682936321	
6	Shygyri Cekoni	Kryeplok / Banor	0682425552	
7	Ikënder Tola	Kryeplok	0674140204	
8	Agim Skodi	Banor	0682631988	
9	Arminada Cekani	Banor	0693841 482	
10	Emkela Buqi	Banor	0693440500	
11	Shaban Cekani	Banor	0682678865	
12				
13				
14				
15				
16				
17				







LISTË PJESMARRJE
DËGJESË PAKETA E MALEVE

STEBLEVE, më ____/____/2025

Nr	Emër/Mbiemër	Institucion, Oj, Banor, Fermer	Telefon	Firmë
1	Figini Gjini	Kryetar Fshati	0677326931	<i>[Signature]</i>
2	Sulejman Doli	Kryetar fshati	0692802653	<i>[Signature]</i>
3	Piza Komelli	Fermer	0675739863	<i>[Signature]</i>
4	SHPETIM CURA	BASHKIA LIBRAZH	068229509	<i>[Signature]</i>
5	Xhek Nezha	Ad. 2M. Elbasan	0696666284	<i>[Signature]</i>
6	Emir Lysyeli	PPMEA	0696503875	<i>[Signature]</i>
7	Dritan Hana	Jegurimet shogerore	0694807710	<i>[Signature]</i>
8	Hekri Rrapci	fermer	0695349153	<i>[Signature]</i>
9	Spahi Rrapci	Fermer	0682752606	<i>[Signature]</i>
10	ADMAND BEGO	PPTMEA	0685387526	<i>[Signature]</i>
11	Laboh Gjini	fermer	0674714315	<i>[Signature]</i>
12	Xhanc Gjini	punëtor	0699766695	<i>[Signature]</i>
13	LULZIM KAMOLLI	FERMER	0682839094	<i>[Signature]</i>
14	JETMIR ISAKU	NËN/KRYETARË	0693659485	<i>[Signature]</i>
15	Romir Trompa	Kryetar Fshati	0682004755	<i>[Signature]</i>
16	ALBERT KALOÇI	ADMINISTRATOR	0674306495	<i>[Signature]</i>
17	Altin Koci	Fushë student	06925503289	<i>[Signature]</i>

18	Ornela Balla	SOEK-IN	0686031456	
19	Elona Kosi	Bashkia Libratid	0699828706	
20	Riamon Tupi	Fermer	0682802686	
21	Festim Balla	K. Borovci	0652782654	
22	ETIVER TUPI	FERMER	0653559846	
23	Flaxhi Gjini	Fermer	0675562053	
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA LIBRAZHD
NJESIA ADMINISTRATIVE LUNIK

Lunik më ____ . ____ , 2025

Lënda: Dëgjes Publike për Paketën e Maleve

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni Ojf, Banor, Fermer	Telefon	Nënshkrimi
1	Shefki Alla	Fermeri	0682377637	Shefki
2	LATIF QETI	FARMER	068538339	Latif
3	Harif Balla	Banor	0682915618	Harif
4	HARI SHKROPI	Banor	0682529593	Hari
5	Lordin Dobro	Fermer	0683298041	Lordin
6	Belul Gollaku	Banor	0683213699	Belul
7	Ayni Sejdiu	Banor	0682326466	Ayni
8	Adhurnim Balla	Banor	0694582589	Adhurnim
9	Kedri Mustaj	Fermer	0694419501	Kedri
10	Trismet Roci	Banor	0682048143	Trismet
11	Fatjon Bisaku	Fermer	0685599251	Fatjon
12	Darim Shkalla	Banor	067556201	Darim
13	Elez Alla	Banor	0695801700	Elez
14	Yulejman Akle	Banor	0684663671	Yulejman
15	Ili Alla	Banor	0682710897	Ili
16	Seferdin Kodra	Banor	068618618	Seferdin
17	Shenkin Guga	Fermer	0681463657	Shenkin
18	Imol Kodra	Banor	0683968149	Imol
19	Buyar Musa	Banor	0684652999	Buyar
20	BESIM DOBRA	BANOR	068294404	Besim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER

Njesia Administrative Qender Librazhd Rruga "Stacioni i trenit" Librazhd

tel. 0694442014

NR XTRA 724

Librazhd, me : 25.08.2025

Lënda : Dëgjese Publike për Paketën e Maleve

NR.	Emër Mbiemër	Institucioni, OJF, Banor Fermer	Telefon	Nënshkrimi
1	Se Poolin Hoxha	Kryetari FSH	068.58.309	
2	Mirjam Xhani	K.F. Gizaresh	069 389 1305	
3	Islam Xheza	Kryetari i Komitetit Arret	0682778120	
4	Begim Hala	K.R. FSHIT LIB. Qendër	0685010849	
5	Jon. Derroni	K.R. FSHIT Derroni	069448840	
6	Alban BALLI	K.F. Dragstaj	0695368175	
7	Recep Doshku	K. FSHIT	067465076	
8	Fatmir Dostan	Anetar i Përgjithshme shtet. DORR	0686402206	
9	Buyar Gjysha	A. D. Peshie	0682568679	
10	Enim Moran	K.R. Lib. Katund	0686952277	
11	DORIAN HAJA	F. Lib. Kat. FERRAR	0682150800	
12	Kufem Allka	Banor Lib. Kat.	0692039525	
13	Nazari XHO	Kryetari	0684412038	
14	MARIGLEN XHABCI	BANOR FSH	0697922965	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER

Njesia Administrative Qender Librazhd Rruga "Stacioni i trenit" Librazhd

tel. 0694442014

Librazhd, me : 25.08.2025

Lënda : Dëgjesë Publike për Paketën e Maleve

NR.	Emër Mbiemër	Institucioni, OJF, Banor Fermer	Telefon	Nënshkrimi
15	Shelvin Hoxha	newr.	Spahere	067.46 98 8644
2	Isuf Cota	Stefan	0676788205	Isuf
3	Mykna Mykna	MARINA7	0676466486	Mykna
4	Besime Mykna			Besime
5	Aleks Bojprani	MERDIZI Rifshati	0693043709	Aleks
6	Ardian Cushi	Kudurman	0682628338	Ardian
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				

ADMINISTRATORI

Roland COTA



RELACION

ZONAT PRIORITARE

BASHKIA LIBRAZHD



Përmbajtja:

- 1- Njësia Administrative Steblevë
- 2- Njësia Administrative Orenjë
- 3- Njësia Administrative Hotolisht
- 4- Njësia Administrative Lunik
- 5- Njësia Administrative Polis
- 6- Njësia Administrative Qendër
- 7- Turizmi dhe Trashëgimit Kulturore
- 8- Aktivitetet Turistike Në Bashkinë Librazhd

■ Paketa e Maleve për Njësinë Administrative Steblevë

ZONA KADASTRALE E NJ.A STEBLEVË






Tabela e përmbajtjes

NJËSIA ADMINISTRATIVE STEBLEVË

Cilët janë Fshatrat e NJ. A Stëblevë
Fshatrat e NJ.A Steblevë në shifra
Infrastruktura dhe shërbimet publike

TURIZMI

Resurset ekonomike dhe atraksionet turistike
Aktivitetet ekonomike
Potencialet | Nevojat | Mundësitë

MODELI I ZHVILLIMIT

Modeli i zhvillimit - Fshatrat e NJ. A Steblevë
Ekonomia
Projektet

Kalendari - Vizito Fshatin Stëblevë

NJ. A Steblevë

Njësia Administrative Steblevë

Njësia Administrative Steblevë është një njësi territoriale në përbërje të Bashkisë Librazhd, në Qarkun e Elbasanit, e pozicionuar në lindje të vendit dhe në kufi me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo njësi përfshin fshatrat Steblevë, Fushë-Studë, Llangë, Borovë, Zabzun dhe Sebisht. Pjesë e Programit të 100+ fshtrave dhe e vendosur brenda Parkut Kombëtar të Shebenik, zona është e njohur për natyrën e saj të ruajtur, historinë, kulturën dhe pasuritë bujqësore e natyrore.

Popullsia

Popullsia rezidente e Njesisë Administrative Steblevë përbëhet nga rreth 1,450 banorë, e cila rritet në 2,560 banorë gjatë sezonit veror, për shkak të rikthimit të emigrantëve dhe pushuesve vendas. Gjithashtu, zona pret çdo vit mbi 142,000 vizitorë, të tërhequr nga natyra, turizmi malor, trashëgimia kulturore dhe aktivitetet agroturistike.

Fshati Llangë-Fushë-Studën është fshati më i populluar i njësisë. Ai ndodhet në një pllajë të rrethuar nga male dhe pyje, dhe shquhet për Liqenin e Fushë-Studës, tokat bujqësore të begata dhe pasuritë natyrore. Llangë është i njohur për arkitekturën tradicionale. Në këtë fshat gjenden ende shtëpi karakteristike prej guri, me çati me rrasa, që përfaqësojnë ndërtimet tipike të zonave malore.

Fshati Steblevë, që i ka dhënë emrin të gjithë njësisë administrative, është një ndër fshatrat më të vjetër dhe më të rëndësishëm në historinë e qarkullimit tregtar midis Shqipërisë dhe Dibrës, Strugës e Selanikut. Ajo ka luajtur rol kyç në lidhjet ndërmjet rajoneve kufitare


Fshati Borovë është një nga fshatrat e vogla dhe të hershme të Njesisë Administrative Steblevë, i vendosur në një zonë kodrinore-malore, fshati Borovë shtrihet përgjatë kufijve të Parkut Kombëtar të Shebenik, një nga zonat më të pasura me burime ujore “Gurrat e famshme”, pyjet me pisha dhe shpellat historike.

Fshati Zabzun është një fshat i hershëm malor, i Njesisë Administrative Steblevë, Bashkia Librazhd. Sot një vendbanim i vogël dhe i qetë, Zabzuni ka pasur një të kaluar të lavdishme si një qytezë e zhvilluar me mbi 400 shtëpi, ku rrugë e shtruar me kalldrëm dhe gjatë natës ndriçoheshi me kandila, në qendër të tij ndodhet ende xhamia e vjetër, një dëshmi arkitekturore dhe shpirtërore e trashëgimisë së fshatit. Zabzuni është gjithashtu i njohur për lidhjen historike me figura të rëndësishme kombëtare, si Qemal Stafa, familja e të cilit ka origjinë nga ky fshat.

Fshati Sebisht është fshati i dytë më i populluar i Njesisë Administrative Steblevë, pas Fushë-Studës. I rrethuar nga pyje me pisha, kullota natyrore dhe zona karakteristike si Zalli i Sebishtit, fshati shquhet për burimet e pastra ujore dhe natyrën e ruajtur.

Ekonomia dhe burimet natyrore

Zona është e pasur me **87 burime ujore**, 18% sipërfaqe në Parkun Kombëtar të Shebenikut, Liqenet Akullnajore, pyjet, shpellat dhe shume monumente culture. Toka bujqësore, edhe pse në lartësi mbi 1,200 m, është pjellore dhe e përshtatshme për prodhimin e qepëve, fasuleve, kungujve dhe sidomos Patates së verdhë të Steblevës, e cila është një nga tre varietete më të vlerësuara në Shqipëri. Blegtoria është një tjetër sektor i rëndësishëm ekonomik, me disa baxho funksionale dhe çobanë që ndjekin traditën e vjetër të përpunimit të bulmetit dhe ruajtjes së trashëgimisë së blegtorisë.



Legjenda

Terreni

Vendbanim

Rrugë kombëtare


Rrugë dytësore


Zonë e mbrojtur natyrore

Element ujor (lumë, liqen)



Harta 2 Fshati Stëblevë





Të dhëna mbi fshatin Stëblevë

Informacione të përgjithshme

Kjo njësi gjendet në përbërje të bashkisë së Librazhdit dhe qarkut Elbasan, i ndodhur në qendër të Shqipërisë.

Popullsia e fshatit të Stëblevës sipas të dhënave të mbledhura në terren është rreth 1300 banorë, Ndërsa mosha mesatare e banorëve të këtij fshati është 43-55 vjeç.

I gjendur në brendësi të Parkut Kombëtar të Shebenik, fshatrat ndodhet rreth 20-35 km larg qytetit të Librazhdit dhe shumë pranë Republikës së Maqedonisë së Veriut. Fshati më i populluar i njesisë, është Fushë-Studa, i cili gjendet në një pllajë të rrethuar nga malet e pyjet.

Prania e shumë elementeve të rëndësishme ujore, e bëjnë zonën e Stëblevës mjaft të pasur me asete të rëndësishme natyrore. Në zonë, njihen rreth 87 burime ujore, dhe për shumicën prej tyre ekzistojnë edhe legjenda e histori të ndryshme.

Edhe pse në lartësi që shkojnë deri në mbi 1200 m, sërish në Stëblevë gjenden toka bujqësore me kultivarë të ndryshëm. Ndër produktet më të spikatura dhe me prodhimtari të madhe, veçohen perimet e vjeshtës, si qepët, fasulet, kungujt, etj. Mirëpo, në Stëblevë ekziston edhe një produkt bujqësor, ndër tre më të rëndësishmit në Shqipëri, siç është Patatja e Stëblevës.

Për shkak të klimës, tokës së pasur, dhe punës së fermerëve e fshatarëve të zonës, patatja e verdhë

e Stëblevës, zë një vend të rëndësishëm në tregjet kombëtare. Dikur, njiheshin 3 varietete patatesh si më të mirat dhe ato ishin: patatja e Kukësit, e Bellovës, dhe e Stëblevës. Banorët e Stëblevës merren gjithashtu me blegtori, për shkak të terrenit të volitshëm dhe kullotave të shumta që gjenden përreth fshatit. Në fshat ka disa çobanë që merren me blegtori, dhe gjithashtu janë të angazhuar me përpunimin e bulmetit e kanë investuar në ngritjen e disa baxhove.

Edhe fshati i Fushë-Studës, një fshat i ri, mbart pasuri të rëndësishme natyrore, siç është Liqeni i Fushë-Studës, si edhe parcelat e begata bujqësore. Pasuritë natyrore të zonës, thuhet se banorët i kanë mbrojtur vetë, edhe në vitet më të vështira në të cilat ka kaluar shoqëria shqiptare. Edhe fshati Llangë mbart vlera të veçanta që lidhen me arkitekturën tradicionale. Në këtë fshat, gjenden ende sot disa shtëpi guri me çati me rrasa guri, që ngjasojnë me tipologjitë e banesave më kullë, të cilat gjenden në zonat malore të Shqipërisë.

Dikur, Stëbleva ka qenë lidhja kryesore e Shqipërisë me zonën e Dibrës, Strugës, e më tej me Manastirin e Selanikut. Stëblevasit janë njohur si popull i besës dhe mes tyre kishte tepër unitet. Ruajtës të traditave e zakoneve shqiptare, ata dikur kishin si veprimtari kryesore tregtinë, dhe ishin mjaft të aftë në këtë fushë. Për shkak të këtij angazhimi, Stëblevasit u njohën me rajonin dhe vendet e ndryshme të botës qysh në kohët më të hershme.

Bujtina & Hotele	Në Stëblëvë, vitet e fundit është shtuar numri i vizitorëve dhe turistëve që frekuentojnë zonën. Ky trend është në rritje, e për këtë nevojitet shtim i kapaciteteve pritëse të zonës me anë të ngritjes së bujtinave të reja, apo adaptimin e më tepër banesave ekzistuese në shtëpi pritëse.
Restorante & Kafene	Traditat kulinare të zonës janë të shumta, mirëpo vendet për t'i konsumuar ato janë të pakta. Në zonë ka disa kafene dhe restorante të vogla, mirëpo me rritjen e interesit të vizitorëve dhe zhvillimin e turizmit, pritet që investimet për restorante agroturistike të nisin.
Dyqane	Të njëjtat biznese që operojnë si bar-kafë funksionojnë edhe si dyqane e mini-markete në fshat. Zakonisht, këto dyqane arrijnë të plotësojnë nevojat e banorëve.
Kamping	Në Stëblevë aktualisht nuk ka zona të posaçme fushimi, mirëpo zona përreth Liqenit të Fushë Studës është përdorur shpesh nga grupe të ndryshme, edhe pse infrastruktura e nevojshme e fushimit mungon.
Shkolla	Shkolla 9-vjeçare e fshatit Stëbleve nuk është funksionale për shkak të numrit të ulët të nxënësve. Aktualisht, ka vetëm 3 nxënës, të cilët në mungesë të shkollës në fshat, frekuentojnë shkollën e Fushë - Studës.
Parking	Aktualisht vendet e parkingut të makinave nuk janë problem në zonë, sepse nuk ka flukse të mëdha automjesh dhe makinash. Parkingu zgjidhet kryesisht nëpërmjet parkimit përgjatë rrugës kryesore. Megjithatë, nevoja për vende parkimi, së bashku me vijëzimin dhe sinjalistën e përshtatshme janë të domosdoshme.
Stacion transporti	Transporti publik në zonë kryhet më anë të furgonëve të linjës Trebisht - Elbasan. Furgoni kalon një herë në ditë, orën 7:00.
Qendër shëndetsore	Në fshat ka vetëm një infermieri, por mungon një qendër shëndetsore. Edhe shërbimi i farmacisë mungon në fshat.
Ujësjellës + KUZ/KUB + Menaxhim i mbetjeve	Linja e ujësjellësit nuk është e përfunduar dhe nuk përmbush kërkesat e banorëve. Rrjetet KUZ/KUB nuk ekzistojnë në zonë, banorët i menaxhojnë me anë të gropave septike. Mbetjet depozitohen informalisht ose digjen nga vetë banorët. Mungon shërbimi i bashkisë.
Rrugë të shtruara	Infrastruktura rrugore kryesore që të lidh më fshatin është e papërfunduar dhe në gjendje jo të mirë, dhe mungon sinjalistika e duhur. Rrugët lidhëse përtej qendrës së fshatit, kanë nevojë urgjente për investime.
Kanalet vaditëse	Rrjeti i kanaleve vaditëse dhe ujitëse është i amortizuar. Banorët shpesh i pastrojnë ato, ose zgjidhin problemin në mënyra individuale.



RESURSET EKONOMIKE DHE ATRAKSIONET TURISTIKE



Resurset ekonomike
dhe atraksionet turistike
që nuk aplikohen në fshat




Resurset ekonomike
dhe atraksionet
turistike sot në fshat



Resurset ekonomike
dhe atraksionet
turistike nesër në fshat

RESURSET EKONOMIKE DHE ATRAKSIONET TURISTIKE



☐ Aktivitetet turistike dhe llojet e turizmit që nuk aplikohen në fshat

○ Aktivitetet turistike dhe llojet e turizmit sot në fshat

Aktivitetet turistike dhe llojet e turizmit nesër në fshat


Not & Vozitje me kajak/kanoe	Në zonën e Stëblevës të pasur me mjaft burime ujore, shihet i mundshëm organizimi i sportit të notit dhe vozitjes me kajak ose kanoe në liqenin e Fushë Studës. Vozitja e lirë amatore mund të zhvillohet krahas aktiviteteve të tjera rekreative që zona përreth liqenit ofron.
Vështrim i shpendëve dhe faunës së egër	Në zonën e Parkut Kombëtar Shebenik - Jabllanicë, për shkak të një shumëllojshmërie të florës dhe faunës, mund të organizohen edhe aktivitetet e vështrimit të shpendëve dhe faunës së egër.
Ski, Alpinizëm & Snowboarding	Për shkak të motit të ftohtë në stinën e dimrit dhe pjerrësive natyrale të disa kodrinavë në zonë, mund të organizohen mjaft mirë sportet e skisë dhe snowboarding, apo edhe alpinizëm në majat e e Draganit, Raduçit, etj.
Çiklizëm malor	Ekzistojnë disa itinerare të përshtatshme për çiklizëm malor në Stëblevë, të cilat janë në nivele mesatare vështirësie dhe mund të jenë interesante për vizitorët e interesuar.
Ecje në natyrë	Aktiviteti i të ecurit në natyrë, apo siç njihet ndryshe hiking, mundësohet në zonën e Stëblevës në një llojshmëri shtigjesh dhe nivelesh vështirësie për shkak të larmisë së terreneve dhe atraksioneve interesante.
Hipizëm	Për shkak se në zonën e Fushë Studës, banorët mbajnë në shtëpi e në tokat kullosore aty pranë, kuaj të racave të ndryshme, shihet me vend organizimi i aktivitetit të hipizmit përreth fshatit dhe liqenit.
Off-road safari + rally	Në rrugën që lidh Stëblevën me zonën e Shëngjergjit në Tiranë mund të zhvillohen aktivitetet e off-road safari apo rally, për shkak të karakterit të egër të zonës dhe rrugëve gjarpëruese malore.
Eksplorim shpellash	Duke qenë se në zonë ka disa shpella interesante, aktiviteti i eksplorimit të tyre, është një ndër më interesantët që zhvillohet.
Kulinari/gastronomi	Gatesat interesante të zonës, bulmeti, si edhe mjalti i cilësisë së lartë paraqesin potencialin e duhur për tërheqjen e vizitorëve të kulinarisë.
Soditje	Pikat panoramike të Stëblevës të cilat shohin Parkun Kombëtar dhe malet përreth tij, përbejnë potencial për aktivitete soditëse.
Artizanat, Edukativ & Shopping	Artizanët dhe zejtarët apo profesionistët e zonës të cilët ushtrojnë zeje të ndryshme janë një potencial i madh për të ndihmuar në zhvillimin e turizmit në fshat, me karakter edukativ si edhe tregtar
Kurativ	Për shkak të lartësisë së terrenit, natyrës së pastër e të egër, mijëra drurëve e pemëve, burimeve ujore me ujëra të pasura në minerale, produkteve të ushqyeshme të zonës, zona e Stëblevës përbën një destinacion që lidhet edhe me turizmin kurativ.



Panoramë e parkut kombëtar 'Shebenik

RESURSET EKONOMIKE DHE ATRAKSIONET TURISTIKE

Emri i atraksionit	Parku Kombëtar Shebenik
Lloji i atraksionit	Atraksion turistik natyror
Status - Ekzistues/Potencial	Park Kombëtar ekzistues
Monument kulture/natyre	Park Kombëtar - Kategoria II (PK)
Përshkrim	Parku Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë" ka një sipërfaqe të përgjithshme 33 927,66 ha, ku pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet pyjore, të ndjekura nga sipërfaqet kullosore, bujqësore, joprodhuese, shkëmbore dhe sipërfaqe troje. Të apasionuarit pas natyrës mund të vizitojnë në këmbë majën e Kallkanit, liqenet e Sal Xhyrës, Vishoricën, majën e Zezë, etj. Në Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë ndodhen edhe disa monumente natyrore si: Mështekna e Qarishtës, Shpella e Kosharishtit, Shpella e malit të Letmit, Burimi i Studnës, Gurra e Kosharishtës, etj. Parku përmban në brendi disa ekosisteme që jetojnë pa ndërhyrjen e dorës së njeriut. Përveç florës, edhe fauna e këtij parku përmban specie të rralla, si: rrëqebulli i Ballkanit, ariu i murrme, etj.
Lloji i turizmit	Turizëm natyror Turizëm rekreativ Turizëm sportiv Turizëm aventure
Aktivitetet	Për shkak të sipërfaqes së konsiderueshme të tij, në zonën e parkut kombëtar mund të zhvillohen aktivitete nga më të ndryshmet që lidhen kryesisht me natyrën dhe eksplorimin e saj. Më tej, edhe festa apo evente të ndryshme më qëllim promovimin e kësaj pasurie dhe ndërgjegjësimin në mbrojtjen e saj mund të ishin me rëndësi.
Sezonaliteti	Aksesohet nga disa fshatra të zonës së Librazhdit që janë pjesë e tij dhe përgjithësisht mund të vizitohet gjatë gjithë vitit. Periudhat më interesante janë ato të ndërrimit të stinëve, pasi edhe përjetimi i tyre në hapësirat me drurë e bimësi të ndryshme është më i plotë.



Pamje vjeshtake e Liqenit të Fushë-Studën pranë pyjeve të parkut kombëtar.

Emri i atraksionit	Liçeni i Fushë Studës
Lloji i atraksionit	Atraksion turistik natyror
Status - Ekzistues/Potencial	Nuk ka status mbrojtjeje Monument potencial
Monument kulture/natyre	Mund të jetë monument potencial natyror i kategorisë III
Përshkrim	Fushë Studa gjendet përgjatë Parkut Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës, shumë pranë fshatit Stëblevë. E vendosur në një pllajë të ftohtë, kjo zonë është e pasur me burime ujore që mbledhen nga malet përreth saj. Liçeni i Fushë-Studës është një liçen artificial që përdoret kryesisht për vaditje. Ai përfaqëson një nga pikat turistike më të vizituara e frekuentuara të të gjithë zonës. Qindra vizitorë shijojnë hapësirat përgjatë tij për piknikë, festa të ndryshme, plazh, etj. Gjatë dimrit, liçeni ngrin në trashësi disa centimetra, e cila mundëson edhe organizimin e patinazhit amator mbi sipërfaqen e tij. Në afërsi të tij, mund të zhvillohen edhe sporte të tjera, si: hipizmi e kalërimi, shëtitje me biçikleta malore, etj.
Lloji i turizmit	Turizëm natyror Turizëm rekreativ Turizëm ditor
Aktivitetet	Për shkak të afërsisë me fshatin, liçeni është një nga zonat më të frekuentuara të Stëblevës. Aktivitete të ndryshme rekreative, sportive, si edhe piknikë, festa, apo panairë mund të zhvillohen me lehtësi pranë tij.
Sezonaliteti	Vizitohet lehtësisht sipas rrugës automobilistike qyteti i Librazhdit – Fushë Studë – Liçeni. Mund të vizitohet në çdo kohë për shkak të rrugës së përshtatshme, megjithatë sugjerohet të vizitohet më tepër gjatë periudhave të ngrohta, për të marrë më mirën e tij.



Pamje e kullave të larta prej guri në fshatin Llangë, i cili gjendet në hyrje të parkut kombëtar 'Shebenik-Jabllanicë'.

Emri i atraksionit	Banesat e Llangës
Lloji i atraksionit	Atraksion turistik kulturor
Status - Ekzistues/Potencial	Nuk ka status të mbrojtur
Monument kulture/natyre	Monument potencial kulturor
Përshkrim	Fshati Llangë, gjendet përgjatë rrugës kryesore që lidh Librazhdin me Stëblevën. Përgjatë parkut Kombëtar të Shebenikut, fshati përbëhet nga disa banesa me tipare të shtëpive tradicionale të tipologjisë kullë. Këto banesa janë të ndërtuara me gurë, dhe kanë çati me tjegulla vendi. Banesat janë të ndërtuar me rreth 3-4 kate, dhe kanë hapje të vogla në muraturë, që nuk klasifikohen të tipit 'frëngji'. Thuhet se këto banesa shërbenin si fronti i parë nga i cili luftëtarët vëzhgonin territorin dhe mbronin zonën e Stëblevës. Këtë gjë, e përforcojnë edhe disa gurë varresh që gjenden pranë banesave në afërsi të rrugës automobilistike. Ky fshat ofron mundësi të zhvillimit të turizmit, mirëpo ka nevojë për ndërhyrje sistemuese dhe restaurese në mënyrë që të kthehet në një pikë ndalesë për vizitorët e shumtë të zonës.
Lloji i turizmit	Turizëm kulturor Turizëm rekreativ Turizëm ditor
Aktivitetet	Për shkak të afërsisë me qytetin e Librazhdit, Stëblevën dhe Parkun Kombëtar Shebenik - Jabllanicë, fshati Llangë është një ndalesë me rëndësi për tu vizituar. Kureshtarët e historisë dhe traditave arkitektonike e kulturore të zonës do të gjejnë në Llangë shumëçka.
Sezonaliteti	Vizitohen me lehtësi sipas rrugës automobilistike qyteti i Librazhdit – Llangë. Mund të vizitohen në çdo kohë për shkak të rrugës së përshtatshme.



Pamje e Fushës së Vakëfit në Stëblevë.

Emri i atraksionit	Fusha e Vakëfit
Lloji i atraksionit	Atraksion turistik natyror
Status - Ekzistues/Potencial	Nuk ka status të mbrojtur
Monument kulture/natyre	-
Përshkrim	Fusha e Vakëfit përbën një zonë të gjëlbbëruar me terren mjaft të ulët e të sheshtë, të përshatshëm për organizimin e festave, festivaleve dhe eventeve të tjera lokale në zonën e Stëblevës. E rrrethuar me drurë të llojeve të ndryshme, në afërsi të saj gjenden edhe burime ujore për të cilat banorët shprehen se janë të pashtershëm.
Lloji i turizmit	Turizëm natyror Ekoturizëm Turizëm ditor
Aktivitetet	Për shkak të afërsisë me Stëblevën zona është lehtësisht e frekuentueshme. Atje zhvillohen aktivitetet e ndryshme lokale për shkak të hapësirës së madhe që ajo ofron. Më tej, ajo përdoret edhe piknikë apo fushim/kamping.
Sezonaliteti	Mund të vizitohet në çdo kohë për shkak të rrugës së përshtatshme, megjithatë periodha më e mirë e vitit është fillim pranvere - fillim vjeshte.



Pamje e një prej tabelave informuese të vendosura nga banorët e Stëblevës për të ndihmuar turistët dhe vizitorët të orientohen drejt gurrës së Sanxhakut.

Emri i atraksionit	87 burimet ujore të Stëblevës
Lloji i atraksionit	Atraksione natyrore
Status - Ekzistues/Potencial	Nuk kanë status të mbrojtur Monumente potenciale
Monument kulture/natyre	Natyre
Përshkrim	Zona e Stëblevës është e njohur për pasuritë e shumta natyrore. Mirëpo, burimet e saj ujore, janë edhe më të larmishme. Nga banorët janë identifikuar gjithsej në territorin e Stëblevës rreth 87 burime ujore, të cilat janë edhe të emërtuara sipas vendndodhjes së tyre, apo historive të ndryshme. Për shumë nga burimet, ekzistojnë edhe legjenda e histori që i bëjnë ato edhe më tërheqëse. Ndër burimet me interesante përmenden: burimi i Gjizaxhiut, burimi i Studnës, gurra e Sanxhakut, Burimi i fushës së Vakëfit, çezmja e Ataturkut, etj. Këto burime mund të bëhen pjesë e tureve interesante natyrore në zonë, pasi nuk do t'i lënë udhëtarët të mbeten asnjëherë të etur për ujë.
Lloji i turizmit	Turizëm natyror Turizëm ditor Turizëm rekreativ
Aktivitetet	Këto burime ujore të shpërndara përqark zonës së Stëblevës, përveçse shërbejnë si pika takimi e orientimi për banorët dhe vizitorët e ndryshëm, ofrojnë edhe mundësi pushimi pranë tyre. Një aktivitet interesant do të ishte vizita e të gjitha burimeve të zonës nga vizitorë kureshtarë, të cilët nuk do të mbeteshin asnjëherë të ujitur në këtë itinerar.
Sezonaliteti	Kyresisht vizitohen me lehtësi dhe disa prej burimeve janë të arritshme edhe me këmbë. Sugjerohet të vizitohen gjatë muajve të ngrohtë të vitit, duke filluar nga pranvera, atëherë kur nis të shkrijë dëbora, dhe sasia e ujit në burime është e lartë.




Figura 1.30 Pamje e jashtme e dy shpellave të Borovës, të cilat mendohen se kanë një lidhje mes tyre, për shkak të terrenit dhe përbërjes së shkëmbit ku ato gjenden.

Emri i atraksionit	Shpellat e Borovës
Lloji i atraksionit	Atraksion turistik natyror
Status - Ekzistues/Potencial	Nuk ka status të mbrojtur Monument potencial
Monument kulture/natyre	Natyre
Përshkrim	Shpellat e Borovës gjenden në zonën e quajtur Borovë, në degëzimin që lidh Fushë-Studën me Stëblevën. Ato janë dy shpella shumë pranë njëra-tjetrës dhe gjenden në të njëjtën faqe mali. Si për shumicën e shpellave në zonë, edhe këto dy shpella kanë legjendat e tyre. Për shkak të historive, ato bëhen edhe më tepër atraktive për vizitorët. Legjenda thotë se dikur aty mendohet se ka qënë fshehur mbreti i Borovës bashkë me të gjithë thesarin e mbretërisë së tij. Më pas, kur u zbulua nga banorët, ai devijoi ujin e lumit aty pranë, duke e kaluar përmes dy shpellave. kështu i gjithë thesari u shpërnda nga rrjedha e ujit. Brenda, shpellat janë me shumë lagështi, dhe muret e tyre janë të lëmuara e mjaft të lagështa. Mendohet se këto dy shpella lidhen bashkë në mënyrë natyrale.
Lloji i turizmit	Turizëm natyror Turizëm kulturore Turizëm aventure
Aktivitetet	Për shkak të afërsisë me fshatin, shpellat e Borovës mund të vizitohen lehtësisht nga kureshtarët pas fromacioneve të tilla gjeologjike si edhe nga të interesuarit në historitë e legjendat e ndryshme që lidhen me thesaret e fshehura në këto shpella.
Sezonaliteti	Vizitohen me lehtësi sipas rrugës automobilistike qyteti i Librazhdit – Fushë Studën – shpellat e Borovës. Mund të vizitohen në çdo kohë, megjithatë periudha më e mirë ëgjatë muajve të ngrohtë, për shkak se shpellat janë të lagështa në brendësi të tyre.

Problematika

Arsimi:

- mungesë nxënësish,
- mungesë e një shkolle funksionale,
- mungesë mirëmbajtjeje dhe vënieje në funksion të shkollës aktuale

Shëndetësia:

- mungesë qendrash shëndetsore të përshtatshme,
- mungesë farmacish

Infrastrukturë dhe shërbime:

- rrugë të pasistemuara e të pashtuara,
- përmytje të rrugëve në raste shirash,
- mungesë hapësirash publike të definuara,
- mungesë ndriçimi,
- mungesë mirembajtje dhe pastrimi të hapësirave publike,
- mungesë sinjalistike të posatshme

Bujqësi dhe blegtori:

- sipërfaqe fermash bujqësore të limituara,
- përmytje të tokave në raste shirash,
- kanale vaditës dhe kullues të amortizuar,
- ndotja e ujit për vaditje,
- mungesë e kontrollit të cilësisë së produkteve,
- mungesë pikash grumbullimi, magazinimi,
- mungesë punishtesh për përpunimin e produkteve,
- mungesë e një vendi tregu,

Turizëm:

- mungesë shërbimesh, si: restorante, bujtina, etj.,

Kapacitete

Burime njerëzore:

- agronomë profesionistë
- fermerë të angazhuar
- qëndistare
- kuzhinierë
- vallëtarë
- këngëtarë popullor
- sipërmarrës

Potenciale**Agroturizëm, Bujqësi, Blegtori:**

- 87 burime ujore
- pasuri natyrore
- përshtatshmëria e tokës për produkte të ndryshme
- vende për verim bagëtie
- kullota alpine
- traditë në prodhim bulmeti
- traditë në përpunim produktesh
- traditë në të gatuar

Turizëm:

- monumente natyrore
- monumente kulturore
- objekte dhe gjurmë historike
- hapësira publike
- aktivitete festive
- festa fetare
- shtigje natyrore
- peizazhe natyrore
- mundësi edukative

Trashëgimi e paprekshme:

- folklor
- etnografi
- kostume popullore
- tradita dhe zakone
- histori dhe gojëdhëna

Përqasja

Krijimi i një strategjie bazuar në nevojat dhe potencialet e fshatit, me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe mungesës së investimeve, nëpërmjet zhvillimit dhe vëmendjes ndaj pasurive aktuale të fshatit të vëna në përdorim nga burimet njerëzore.

Me qëllim arritjen e shfrytëzimit të plotë të mundësive dhe tejkalimin e pengesave, nevojitet ndërlidhja e plotë e të gjitha hallkave përbërëse të zinxhirit të fshatit: institucione publike, sipërmarrës dhe biznesë private, kapitali njerëzor i paqeshëm dhe kapital natyror e kulturor i vendit.




Figura 1.40 Grafikë e përfaqësjes strategjike të zhvillimit të rajonit 09.

Përfaqësja strategjike

Përfaqësja strategjike bazohet në pesë shtylla të rëndësishme që vënë në lëvizje të gjithë **ciklin e zhvillimit** të fshatrave të lot-it 9.

Hallkat e zinxhirit nisin nga **komuniteti** dhe synojnë **fuqizimin e individit**, si anëtar i një **grupimi më të madh ndëreveprues**. Ky zinxhir pasurohet me **investime** të cilat mbështesin **mirëfunksionimit e fshatit**, dhe u japin shtysë **modeleve të zhvillimit** me bazë **kapacitetet njerëzore** të vetë fshatit.

Kështu, cikli mbetet i plotë dhe nxit një *perpetum mobile* me synim arritjen e sa më tepër investimeve dhe sipërmarrjeve nga vetë banorët.

NDËRVEPRIM
KOMUNITAR



FESTA



PANAIRE



TREGJE



SEZONE

FUQIZIM
KOMUNITETI



TURE



RESTORANT



BASHKËPUNIME



MIKPRITJE

SHËRBIME
VETË-PËRMBUSHËSËSE



TREGTI



PËRPUNIME



MAGAZINIM



SHTIM PRODHIMI

MODELE
ZHVILLIMI



BUJQËSI



BLEGTORI



SHTËPI PRITËSE



ARTIZANAT

INVESTIME
PARËSORE



UJË &
KANALIZIME



ENERGJI
ELEKTRIKE




HAPËSIRA
PUBLIKE



INFRASTRUKTURË
& MIRËMBAJTJE

Skemë shpjeguese e pjesëzave të ciklit strategjik të zhvillimit të fshatrave të rajonit 09.




Imazh përfaqësues i projektit të sistemit të shëshit të Fushë Studën në Stëblevë.

Emri i projektit	Sistemim i sheshit të Fushë-Studën
Përkatësia e sektorit	Infrastrukturë, rigjenerim urban, turizëm
Përshkrim i shkurtër	Ky projekt konsiston në shtrimin dhe sistemimin e qendrës së fshatit Fushë-Studën, pasi fshati vuan nga mungesa e një hapësire publike të mirëfilltë. Shtrimi i qendrës me gurë natyrorë të zonës, krijimi i hapësirave të gjelbra, vendosja e mobiljeve urbane, ngritja e bizneseve të vogla, si edhe sistemimi i rrugëve që përshkojnë qendrën janë disa nga pikat kryesore të projektit.
Lloji i investimit	Investim publik & privat Aktorët financiarë mbështetës: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Bashkia Librazhd, IPARD II, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Programi 100+ Fshatrat
Prioriteti	Projekt me prioritet parësor për zonën.
Kohëzgjatja	Ky investim strategjik mund të zhvillohet me faza. Kohëzgjatja e parashikuar për finalizimin e projektit është 1-2 vite.
Kosto e përafërt	300 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Tabela 1.1 Paketa e investimit të sistemit të sheshit të Fushë Studën.




Imazh përfaqësues i projektit të magazinës së produkteve bujqësore në Stëblevë.

Emri i projektit	Magazina e produkteve bujqësore
Përkatësia e sektorit	Infrastrukturë, bujqësi
Përshkrim i shkurtër	Stëbleva është një fshat që prodhon shumë kultura bujqësore. Veçanërisht e njohur për pataten e Stëblevës, si një nga tre varietetet më të mira shqiptare. Për shkak të mungesës së aksesit/transportit, tregut, si edhe kushteve jo të mira për të ruajtur prodhimet, sasi të mëdha prodhimi bujqësor shkojnë dëm. Për të shmangur këtë, nevojitet krijimi i një hapësire të përbashkët magazinimi, ruajtjeje, frigoriferimi për të gjithë fermerët e zonës. Edhe brandimi, certifikimi dhe arritja e cilësisë sipas standardeve është me prioritet.
Lloji i investimit	Investim publik dhe privat Nismëtarët: Aktorët financiarë: IPARD II, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Programi 100+ Fshatrat
Prioriteti	Projekt publik me prioritet parësor për fshatin dhe të gjithë zonën e Stëblevës.
Kohëzgjatja	Ky investim strategjik mund të zhvillohet me faza. Kohëzgjatja e parashikuar për finalizimin e projektit është 1-1.5 vite.
Kosto e përafërt	40 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Tabela 1.2 Paketa e investimit të magazinës së produkteve bujqësore.



Imazh përfaqësues i projektit të Dhomës së Ngjarjeve dhe Historive Lokale në Stëblevë.

Emri i projektit	Dhoma e ngjarjeve dhe historive vendase
Përkatësia e sektorit	Infrastrukturë, restaurim, trashëgimi
Përshkrim i shkurtër	Dhoma e ngjarjeve dhe historive vendase merr shkas nga pasuria folklorike, historike, dhe etnografike e zonës së stëblevës. Kjo hapësirë synon shpalosjen e këtyre paurive drejt vizitorëve të zonës, me anë të trajtimit si një muze. Përveç krijimit të një hapësire të përshtatshme, qëllim tjetër i projektit është edhe përçimi dhe kujtimi i vlerave të zonës ndër breza.
Lloji i investimit	Investim publik & privat Nismëtarët: Aktorët financiarë mbështetës: Ministria e Kulturës, Instituti i Studimeve Albanologjike, Bashkia Librazhd, donatorë të jashtëm, Programi 100+ Fshatrat
Prioriteti	Projekt me prioritet dytësor
Kohëzgjatja	Ky investim mund të zhvillohet me faza. Kohëzgjatja e parashikuar për finalizimin e projektit është 2 vite.
Kosto e përafërt	120 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Tabela 1.3 Paketa e investimit të Dhomës së Ngjarjeve dhe Historive Lokale.



Imazh përfaqësues i projektit të Observatorit të Stëblevës.

Emri i projektit	Observatori i Stëblevës
Përkatësia e sektorit	Kulturë, edukim, turizëm
Përshkrim i shkurtër	Fshati Fushë-Studën shtrihet në një fushë të gjerë malore në lartësi 900 m mbi nivelin e detit. Gjatë netëve pranverore dhe verore, ofron nje pamje të bukur qiellore dhe lehtëson vëzhgimin e yjërive. Ky observator, është një sipërmarrje e një nismëtari të zonës i cili ka nisur punën për ofrimin e këti shërbimi. Megjithatë, nevojitet mbështetja financiare nga burime të ndryshme, si edhe përmirësimi i infrastrukturës, në mënyrë që ky biznes të kthehet në atraksion turistik duke nxitur zhvillimin e keonomisë së zonës, nëpërmjet turizmit.
Lloji i investimit	Investim publik & privat Nismëtarët: Aktorët mbështetës: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Programi 100+ Fshatrat, GIZ
Prioriteti	Projekt me prioritet dytësor.
Kohëzgjatja	Koha e parashikuar për finalizimin e projektit është rreth 1 vit.
Kosto e përafërt	20 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Tabela 1.4 Paketa e investimit të Observatorit të Stëblevës.




Imazh pērfagēsues i projektit tē bujtīnave nē Siēblevē.

Emri i projektit	Ngritja e bujtinave të reja
Përkatësia e sektorit	Infrastrukturë, turizëm
Përshkrim i shkurtër	Zona e Stëblevës përmban bukuri të shumta natyrore dhe ka një kulturë e folklor të pasur. Kjo bën që fshati të jetë destinacion për shumë turistë e vizitorë. Kërkesa e turistëve për të qëndruar në zonë, shpesh nuk mbulohet dot nga oferta e bujtinave dhe shtëpive pritëse, për këtë arsye nevojitet shtimi i numrit të shtretërve dhe vendeve të qëndrimit për vizitorët. Projekti synon ndërtimin e bujtinave të reja me materiale ekologjike, si edhe përshtatjen e banesave të banorëve vendas në shtëpi pritëse.
Lloji i investimit	Investim Nismëtarët: Aktorët mbështetës: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, IPARD II, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Programi 100+ Fshatrat, GIZ
Prioriteti	Projekt me prioritet dytësor.
Kohëzgjatja	Ky projekt mund të zhvillohet me faza. Kohëzgjatja e parashikuar është rreth 1-4 vite.
Kosto e përafërt	300 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Tabela 1.5 Paketa e investimit të bujtinave të reja në Stëblevë.



Imazh përfaqësues i projektit 'Fusha e Kalorësit' në Stëblevë.

Emri i projektit	Fusha e Kalorësit
Përkatësia e sektorit	Infrastrukturë, sporte, turizëm
Përshkrim i shkurtër	Zona e Fushë-Studës njihet për shtrirjen e gjerë në formë pllaje mës maleve. Banorët e zonës mbajnë kuaj të cilët i përdorin për transport, dhe ofrimi i një hapësire të përshtatshme për kuajt (stalla, manezh) do të ishte me dobi për vetë banorët, por edhe do të shtonin ofertën turistike për vizitorët. Ndërtimi i këtyre hapësirave me materiale ekologjike, do të mundësojë një formë të re turizmi dhe sporti, që lidhet me qëllime edukative (trajnime e instruksione).
Lloji i investimit	Investim publik & privat Nismëtarët: banorët e zonës së Fushë-Studës Aktorët mbështetës: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Ministria e Arsimit, IPARD II, Programi 100+ Fshatrat, Universiteti i Sporteve
Prioriteti	Projekt me prioritet dytësor.
Kohëzgjatja	Ky projekt mund të zhvillohet në fazë. Kohëzgjatja e parashikuar është 1-2 vite.
Kosto e përafërt	40 000 EUR (çmim referencial)



Imaž pārfaqēsues i projektū tē sporte nē natyrē.

Emri i projektit

Sporte në natyrë

Përkatësia e sektorit

Infrastrukturë, sporte, turizëm

Përshkrim i shkurtër

Zona e Stëblevës ofron pasuri të shumta natyrore të cilat për nga veçantia, përmbushin disa nevoja të veçanta. Liqeni i Fushë-Studës, Parku Kombëtar i Shebenik-Jabllanicës, si edhe e gjithë hapësira natyrore përreth Stëblevës, mund të shfrytëzohen për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive. Sporte në ujë, patinazh mbi liqen, gara me biçikleta malore, gara *off-road*, etj. kanë potencialin të zhvillohen në këtë territor.

Lloji i investimit

Investim privat dhe publik

Aktorët financiarë mbështetës: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Agjenci të ndryshme turistike, OJF, Programi 100+ Fshatrat, Universiteti i Sporteve, GIZ

Prioriteti

Projekt me prioritet dytësor.

Kohëzgjatja

Ky projekt strategjik mund të zhvillohet me faza dhe në mënyrë periodike të përvitshme në bazë të festave e garave të ndryshme që do të zhvillohen.


Kosto e përafërt

20 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Tabela 1.6 Paketa e investimit të sporteve të natyrës.



Imazh përfaqësues i projektit të sistemit të infrastrukturës për vizitorë në shpellat e Boroves.

Emri i projektit	Infrastruktura për vizitorë në Shpellat e Boroves
Përkatësia e sektorit	Infrastrukturë, kulturë, turizëm
Përshkrim i shkurtër	E e ndodhur në një shkëmb të lartë e të thepisur, bëhet thuajse e pamundur të kalosh në të, prandaj shihet me rëndësi ndërtimi i një shkallareje druri që bën të mundur aksesimin e saj për të gjithë të interesuarit. Investimi për përmirësimin e rrugës që të lidh me shpellën është gjithastu i një rëndësie të veçantë.
Lloji i investimit	Investim publik Aktorët financiarë mbështetës: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Ministria e Kulturës, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Programi 100+ Fshatrat
Prioriteti	Projekt me prioritet dytësor.
Kohëzgjatja	Ky investim strategjik mund të zhvillohet me faza. Kohëzgjatja e parashikuar për ndërtimin e rrugës, sistemimin e jashtëm dhe ndërtimin e shkallares është rreth 1.5 vite.
Kosto e përafërt	20 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Paketa e investimit të infrastrukturës për vizitorë në shpellën eremite.

Hapja e qendrës kufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut
'Piramida 30'

Infrastrukturë

Rihapja e pikës kufitare që lidh Stëblevën me Republikën e Maqedonisë së veriut, do të ndihmojë në shkurtimin e distancës që banorët kryejnë për të arritur në shtetin fqinj, si edhe do të nxitë shkëmbimin tregtar, kulturor, dhe turistik duke i afruar dy komunitetet ndërkufitare me njëri-tjetrin.

Përveç çështjes ligjore, nevojitet edhe ndërtimi i qendrës kufitare, i cili është marrë përsipër nga Shoqata 'Stëbleva'

Investim privat dhe publik

Nismëtarët:

Aktorët mbështetës: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Projekt me prioritet dytësor.

Ky projekt strategjik mund të finalizohet për rreth 1 vit.

100 000 EUR (çmim referencial)

Emri i projektit

Përkatësia e sektorit

Përshkrim i shkurtër

Lloji i investimit

Prioriteti

Kohëzgjatja

Kosto e përafërt



Paketa e investimit të piramidës 30.


Paketa e investimit

Emri i projektit	Resorti i skive në Stëblevë
Përkatësia e sektorit	Infrastrukturë, sporte, turizëm
Përshkrim i shkurtër	Disa prej kodrave të buta në zonën e Stëblevës ofrojnë një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e sporteve dimërore. Stëbleva, mbulohet nga dëbora në fund dhjetori - fillim marsi, dhe kjo kohëzgjatje mundëson lehtësisht organizimin e sporteve të skisë, snowboarding, etj.
Lloji i investimit	Investim privat & publik Nismëtarët: Aktorët financiarë mbështetës: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, IPARD II, Agjencia e Zhvillimit Rural, Programi 100+ Fshatrat, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Prioriteti	Projekt me prioritet dytësor.
Kohëzgjatja	Ky investim strategjik mund të zhvillohet me faza. Kohëzgjatja e parashikuar është 2 vite.
Kosto e përafërt	100 000 EUR (çmim referencial)

Paketa e investimit



Tabela 1.9 Paketa e investimit të resortit të skive në Stëblevë.



STĚBLEVĚ

QESHOR	KORRIK	GUSHT	SHATATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	MAJ	PRILL	MARS	SHKURT	JANAR
1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9
10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	10
11	11	11	11	11	11	11	11	11	11	11	11
12	12	12	12	12	12	12	12	12	12	12	12
13	13	13	13	13	13	13	13	13	13	13	13
14	14	14	14	14	14	14	14	14	14	14	14
15	15	15	15	15	15	15	15	15	15	15	15
16	16	16	16	16	16	16	16	16	16	16	16
17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17
18	18	18	18	18	18	18	18	18	18	18	18
19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19
20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20
21	21	21	21	21	21	21	21	21	21	21	21
22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22	22
23	23	23	23	23	23	23	23	23	23	23	23
24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24
25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25
26	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26
27	27	27	27	27	27	27	27	27	27	27	27
28	28	28	28	28	28	28	28	28	28	28	28
29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29
30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30
31	31	31	31	31	31	31	31	30	31	29	31

KALENDARI - VIZITO FSHATIN STËBLEVË

Fund Janari	Mundësi për alpinizëm, ski, snowboarding
14 Mars	Dita e Verës
1 Maj	Dita e Punëtorëve
5 Maj	Dita e Dëshmorëve
6 Maj	Festa e Luleve (Shëngjergj)
21 Maj	Festa e Parkut Kombëtar
Fund Maji - Mes Qershori	Mbledhja e frutave dhe perimeve të stinës së pranverës. Vështrim yjesh dhe konstelacionesh.
2 Gusht	Festa në Fushën e Letmit
Mes Shtatori - Mes Tetori	Mbledhja e patateve, rrushit, mollëve, dardhave
2 Tetor	Festa e Patates
28-29 Nëntor	Vjelja e pjeshkëve dhe nektarinave të hershme
Fund Dhjetori	Patinazh mbi liqenin e ngrirë të Fushë Studës

■ Paketa e Maleve për Njësinë Administrative Orenjë

Njësia Administrative Orenjë shtrihet në veri-perendim të Librazhdit dhe përfshin disa fshatra me potencial të lartë turistik, nga të cilët më të spikaturit janë **Floq, Neshtë dhe Orenjë**. Këto fshatra ofrojnë një kombinim unik të natyrës së paprekur, ajrit të pastër, burimeve ujore, historisë dhe gastronomisë tradicionale. Ato përbëjnë një itinerar të plotë për turizëm natyror, kulturor dhe rural.




Numri banorëve total ne Njesine Administrative Orenjë: 4362

Numri i familjeve ne Njesine Administrative Orenje:1606

■ Neshtë (zona kadastrale 2728) – Ajri i freskët i pyjeve të dendura

Fshati Neshtë shtrihet në lindje të Njësisë Administrative Orenjë, i rrethuar nga pyje të dendura që krijojnë një klimë të freskët dhe të shëndetshme. Ai njihet si destinacioni ideal për pushime larg zhurmës dhe ndotjes, me terren të përshtatshëm për ndërtimin e bujtinave dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Fermerët vendas ofrojnë produkte bio si mish, qumësht, fruta dhe perime të freskëta, duke e bërë zonën të përshtatshme për agroturizëm. Shëtitjet malore, ecjet në natyrë dhe përvoja autentike rurale janë asetet më të rëndësishme që Neshta ofron për vizitorët.



■ Floq (zona kadastrale 1632) – Liqeni karstik & Fusha e Foqit

Fshati Floq ndodhet në një territor malor në pjesën veriore të njësisë, i njohur për bukuritë natyrore dhe trashëgiminë kulturore. Ai ka një liqen karstik unik dhe burimin e njohur të “Ujit të Ftohtë”, që tërheqin vizitorë nga e gjithë zona. Floqi ka gjithashtu një fushë të madhe, e dyta më e madhe në Librazhd pas Fushë-Studënit, e cila ofron hapësirë për aktivitete sportive dhe ngjarje tradicionale. Nga kurora e pishave në majë të fshatit, vizitorët mund të sodisin një pamje panoramike të jashtëzakonshme mbi gjithë zonën. Tradita e **Ditës së Verës**, një nga festat më të vjetra shqiptare, ka origjinën pikërisht në Floq, duke e kthyer fshatin në një pikë të rëndësishme kulturore. Aktualisht në Floq operojnë restorante me gatime tradicionale bio, ndërsa krijimi i bujtinave për akomodim është një prioritet zhvillimor.



■ Orenjë (zona kadastrale 2829)– Histori dhe mikpritje

Fshati Orenjë Katund është një nga vendbanimet më të hershme të zonës, i njohur për freskinë, klimën dhe historinë e tij. Ai shtrihet pranë qytezës së vjetër, duke mbajtur gjurmë historike dhe kulturore që i japin identitet të veçantë. Sot në Orenjë Katund operojnë 2-3 bujtina, të cilat përfaqësojnë “dallandyshtet e para” të turizmit të organizuar në këtë zonë. Këto bujtina ofrojnë jo vetëm akomodim, por edhe përvoja autentike me gatime tradicionale dhe mikpritje të ngrohtë. Zhvillimi i mëtejshëm i këtij fshati lidhet me promovimin e trashëgimisë historike, shtimin e bujtinave dhe integrimin e tij në itineraret turistike kulturore dhe natyrore të Çermenikës.



■ ■ Gastronomía e përbashkët

Një element që i bashkon këto tre fshatra është gastronomia tradicionale e pasur dhe e bazuar në produkte bio. Vizitorët mund të shijojnë byrekë me hithra dhe lakra të egra, mish të pjekur në saç, gjellëra të gatuar me fasule dhe perime vendi. Gjithashtu, produktet e freskëta si djathi, kosi, gjalpi, mjalti dhe vera e bërë në shtëpi, e kthejnë çdo darkë në një eksperiencë autentike. Kjo e bën zonën të përshtatshme për zhvillimin e agroturizmit si një prej degëve më të qëndrueshme të turizmit rural.

■ Drejt një destinacioni të qëndrueshëm

Ky plan zhvillimor synon të krijojë një itinerar turistik që bashkon natyrën, kulturën dhe traditën. Hapat kryesorë për zhvillimin e zonës janë:

- Ndërtimi i rrjeteve të bujtinave në çdo fshat.
- Nxitja e ekoturizmit dhe agroturizmit.
- Promovimi i eventeve kulturore si Dita e Verës në Floq.
- Përfshirja e fermerëve dhe komunitetit lokal në ofertën turistike.
- Zhvillimi i aktiviteteve sportive dhe natyrore (hiking, kamping, ecje në pyje, panaire lokale). Në këtë mënyrë, Floq, Neshtë dhe Orenjë Katund nuk do të jenë vetëm destinacione turistike, por edhe modele të turizmit të qëndrueshëm në Librazhd dhe më gjerë.

■ Paketa e Maleve për Njësinë Administrative Hotolisht



Në kuadër të analizës dhe identifikimit të zonave me potencial për zhvillim të qëndrueshëm në Njësinë Administrative Hotolisht, janë vlerësuar disa zona sikurse janë Rezervuri I Fshatit Dardhë, Rezervuri I Fshatit Hotolisht, Rezervuri I Fshatit Vehçan , Lagja Xhyrë Mal Hotolosht këto zona i përfaqeson një ndër hapësirat me prioritete të larta strategjike. Zgjedhja e këtyre zonave bazohet në një sërë faktorësh natyrorë, ekonomikë, kulturorë që i bëjnë këto pika kyçe për investime, zhvillim turistik dhe ruajtje të trashëgimisë natyrore. Zgjedhja e këtyre zonave prioritare ka për qëllim:


- Potencial I lartë turistik Fshati Dardhë ofron pamje të jashtëzakonshme dhe shumë histori pamje spektakolare, klimë të freskët dhe biodiversitet të pasur, ky potencial e bën zonën të përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor dhe turizëm të aventurës (si ecje, kamping, alpinizëm) dhe krijimi i pikave turistike. është përzgjedhur nga qeveria mes 100 fshatrave turistik ku do të investohet me qëllim zhvillimin ekonomik dhe turistik të zonës
- Vlerat natyrore-kulturore dhe mjedisore Zona përreth është shumë e pasur si për nga flora ashtu dhe nga fauna ku ofrojnë pamje spektakolare , klimë freskët dhe biodiversitet të pasur. Kjo është një zonë me pasuri natyrore dhe historike që datojnë që në kohën e Skenderbeut. Këtu ndodhet mulliri i vjetër shekullor, si dhe rruga Egnatia e cila ka qenë një rrugë kyçe që lidhej me Turqinë , gjithashtu ndodhet Guri I Skenderbeut , Shpella e Plakës etj Turistët nuk magjepsen vetëm nga trashëgimia historike që ky fshat mbart, por dhe nga kulinaria e veçantë e zonës

- Rëndësia ekonomike Zhvillimi I zonës do të krijojë mundësi të reja ekonomike për banorët e Njesisë Administrative Hotolisht përmes rritjes së të ardhurave nga turizmi, shitjes së produkteve bio dhe artizanale, si dhe investimi në Bujtina të vogla ku deri tani kemi 2 në fshatin e Dardhës “Bujtina Shpella e Plakes” si dhe “Bujtina House Grill Mattia” pranë burimit të Gurrës së Zezë
- Mungesa e zhvillimit të mëparshëm Zona nuk ka pasur ndërtime masive apo shfrytëzime të tepruar kjo e bën një vlerë shumë të kërkuar në tregun modern të turizmit. Investimi në këtë zonë nuk është thjeshtë një zgjidhje strategjike por një mundësi për të krijuar një histori suksesi që mund të shërbejë si model për të gjithë rajonin.
- Fshati Hotolisht është një fshat që shtrihet në pjesën e parkut Shebenik – Jabllanicë, kufizon me fshatrat Kokreve e Dragostunjë dhe me lumin Shkumbin. Pjesa për turizem është Lagjia e Frarit ku ekziston dhe rezervuari I fshatit ku familjarët rrethojnë rezervuarin dhe mund të hapin bujtina ose dhoma të shtëpive të tyre duke i kthyer në dhoma pritje për turistët, për të harxhuar, konsumuar produktet e tyre si blektorale, fruta e perime, etj. Lagjia e Bogdanit po ashtu është një atraksion tjetër turistik ku është blloku me pisha veçse duhet uje I pijshëm për të bërë bujtina për turizem.
- Fshati Xhyre-Mal është një fshat me venbanim malor e bukuri natyrore të rralla, I vendosur në një zonë me reliev të thyer, Me popullsi mikpritese dhe tradita të pasura ky fshat përfaqëson një potencial të madh për zhvillimin e turizmit rural, kulturor historik. Kultura, mënyra tradicionale e jetesës dhe kulinaria vendase Potenciali turistik mund të zhvillohet në disa drejtime kryesore si : 1. Turizmi natyror (shëtitje në natyrë, ecje malore) Guri I Bletës. 2. Turizmi kulturor : vizite në shtëpi tradicionale, festival, etj. Ka mundësi për alpinizëm, çiklizëm malor, eksplorim shpellash, kuzhina tradicionale e produktet bio Nga ana e vlerave historike aty ndodhet një nga rruget me të lashta siç është Rruga Egnatia e ndërtuar nga romakët rreth shekullit të 11 p.e.s. Kjo rrugë është një mundësi e madhe për ta vendosur fshatin Xhyre-Mal në hartat turistike dhe kulturore në Ballkan
- Rezervuari i Fshatit Vehçan ose Liqeni I Varrit të Plakës i cili ndodhet mbi fshatin Vehçan ku ofron një pamje spektakolare duke përfshirë pyllin me pisha .Investimi I bërë nga Bashkia Librazhd asafitimi I rrugës së fshatit Vehçan ka bërë me të aksesueshme investimin në bujtina po ashtu dhe për turistët
- Diversiteti natyror në Parkun Shebenik-Jabllanicë është shumë I pasur ,si për nga flora ashtu dhe nga fauna.

■ Paketa e Maleve për Njësinë Administrative Lunik

(Letem, Koshorisht, Lunik)

ZONAT KADASTRALE E NJ.A LUNIK



NJ. A LUNIK

Njësia Administrative Lunik

Njësia Administrative Lunik është një njësi territoriale në përbërje të Bashkisë Librazhd, në Qarkun e Elbasanit, Kjo njësi përfshin fshatrat Dranovce, Koshorish, Kostenjë, Letëm, Lunik, Prevall and Zgosht dhe një pjesë e fshatrave janë vendosur brenda Parkut Kombëtar të Shebenik, zona është e njohur për natyrën e saj të ruajtur, historinë, kulturën dhe pasuritë bujqësore e natyrore.

Popullsia

Popullsia rezidente e Njesisë Administrative Lunik përbëhet nga rreth 2,6500 banorë, e cila rritet në 2,560 banorë gjatë sezonit veror, për shkak të rikthimit të emigrantëve dhe pushuesve vendas. Gjithashtu, zona pret çdo vit mbi 142,000 vizitorë, të tërhequr nga natyra, turizmi malor, trashëgimia kulturore dhe aktivitetet agroturistike.

Ekonomia dhe burimet natyrore

Ekonomia e Njesisë Administrative Lunik bazohet kryesisht në:

Bujqësi – Banorët merren me kultivimin e drithërave, perimeve dhe frutave tradicionale. Toka është kryesisht kodrinore, ndaj bujqësia zhvillohet në sipërfaqe të vogla, por me mundësi për kultivime biologjike dhe produkte tradicionale.

Blegtori – Një nga shtyllat kryesore ekonomike të zonës, ku familjet rrisin kryesisht bagëti të imta (dele, dhi) dhe bagëti të trasha (lopë, gjedhë). Produktet si qumështi, djathi, mishi dhe nënproduktet e tyre kanë cilësi të lartë dhe mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e agropërpunimit.

Blegtoria është një tjetër sektor i rëndësishëm ekonomik, me disa baxho funksionale dhe çobanë që ndjekin traditën e vjetër të përpunimit të bulmetit dhe ruajtjes së trashëgimisë së blegtorisë.

Njësia Lunik ka një potencial të pasur natyror, që përbën një aset të rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm:

Ujërat – Zona ka burime të shumta ujore, përfshirë përrenj dhe burime malore me ujë të pijshëm cilësor, të cilat mund të shfrytëzohen për konsum, turizëm dhe agrobiznes.

Pyjet – Shtrihen në një sipërfaqe të konsiderueshme dhe ofrojnë dru zjarri, bimësi të egër mjekësore e aromatike (si sherebela, rigoni, boronica, gështenja, manaferra).


Kullotat – Janë një pasuri me rëndësi për zhvillimin e blegtorisë, sidomos për bagëtinë e imët.

Toka bujqësore – Edhe pse jo shumë e gjerë, është e përshtatshme për kultivimin e kulturave tradicionale dhe me potencial për bujqësi organike.

Peizazhi natyror – Relievi kodrinor e malor, pamjet panoramike dhe natyra e paprekur janë një burim i madh për turizmin natyror dhe malor.

Bujtina & Hotele	Në Lunik, vitet e fundit është shtuar numri i vizitorëve dhe turistëve që frekuentojnë zonën. Ky trend është në rritje, e për këtë nevojitet shtim i kapaciteteve pritëse të zonës me anë të ngritjes së bujtinave të reja, apo adaptimin e më tepër banesave ekzistuese në shtëpi pritëse.
Restorante & Kafene	Traditat kulinare të zonës janë të shumta, mirëpo vendet për t'i konsumuar ato janë të pakta. Në zonë ka disa kafene dhe restorante të vogla, mirëpo me rritjen e interesit të vizitorëve dhe zhvillimin e turizmit, pritet që investimet për restorante agroturistike të nisin.
Dyqane	Të njejtat biznese që operojnë si bar-kafe funksionojnë edhe si dyqane e mini-markete në fshat. Zakonisht, këto dyqane arrijnë të plotësojnë nevojat e banorëve.
Kamping	Në Stëblevë aktualisht nuk ka zona të posaçme fushimi, mirëpo zona përreth Liqenit të Fushë Studës është përdorur shpesh nga grupe të ndryshme, edhe pse infrastruktura e nevojshme e fushimit mungon.
Shkolla	Shkolla 9-vjeçare e fshatit Stëbleve nuk është funksionale për shkak të numrit të ulët të nxënësve. Aktualisht, ka vetëm 3 nxënës, të cilët në mungesë të shkollës në fshat, frekuentojnë shkollën e Fushë - Studës.
Parking	Aktualisht vendet e parkingut të makinave nuk janë problem në zonë, sepse nuk ka flukse të mëdha automjeteve dhe makinash. Parkingu zgjidhet kryesisht nëpërmjet parkimit përgjatë rrugës kryesore. Megjithatë, nevoja për vende parkimi, së bashku me vijëzimin dhe sinjalistën e përshtatshme janë të domosdoshme.
Stacion transporti	Transporti publik në zonë kryhet me anë të furgonëve të linjës Trebisht - Elbasan. Furgoni kalon një herë në ditë, orën 7:00.
Qendër shëndetsore	Në fshat ka vetëm një infermieri, por mungon një qendër shëndetsore. Edhe shërbimi i farmacistë mungon në fshat.
Ujësjellës + KUZ/KUB + Menaxhim i mbetjeve	Linja e ujësjellësit nuk është e përfunduar dhe nuk përmbush kërkesat e banorëve. Rrjetet KUZ/KUB nuk ekzistojnë në zonë, banorët i menaxhojnë me anë të gropave septike. Mbetjet depozitohen informalisht ose digjen nga vetë banorët. Mungon shërbimi i bashkisë.
Rrugë të shtruara	Infrastruktura rrugore kryesore që të lidh më fshatin është e papërfunduar dhe në gjendje jo të mirë, dhe mungon sinjalistika e duhur. Rrugët lidhëse përtej qendrës së fshatit, kanë nevojë urgjente për investime.
Kanalet vaditëse	Rrjeti i kanaleve vaditëse dhe ujitëse është i amortizuar. Banorët shpesh i pastrojnë ato, ose zgjidhin problemin në mënyra individuale


Vështrim i shpendëve dhe faunës së egër		Në zonën e Parkut Kombëtar Shebenik - Jabllanicë, për shkak të një shumëllojshmërie të florës dhe faunës, mund të organizohen edhe aktivitetet e vështrimit të shpendëve dhe faunës së egër.
Ski, Alpinizëm & Snowboarding		Për shkak të motit të ftohtë në stinën e dimrit dhe pjerrësive natyrale të disa kodrinavë në zonë, mund të organizohen mjaft mirë sportet e skisë dhe snowboarding, apo edhe alpinizëm në majat e Lunikut dhe Fushat e Letmit.
Çiklizëm malor		Ekzistojnë disa itinerare të përshtatshme për çiklizëm malor në Letem dhe Koshorisht, të cilat janë në nivele mesatare vështirësie dhe mund të jenë interesante për vizitorët e interesuar.
Ecje në natyrë		Aktiviteti i të ecurit në natyrë, apo siç njihet ndryshe hiking, mundësohet në zonën e Stëblevës në një llojshmëri shtigjesh dhe nivelesh vështirësie për shkak të larmisë së terreneve dhe atraksioneve interesante.
Hipizëm		Për shkak se në zonën e Fushë Studës, banorët mbajnë në shtëpi e në tokat kullosore aty pranë, kuaj të racave të ndryshme, shihet me vend organizimi i aktivitetit të hipizmit përreth fshatit dhe liqenit.
Off-road safari + rally		Në rrugën që lidh Stëblevën me zonën e Shëngjergjit në Tiranë mund të zhvillohen aktivitetet e off-road safari apo rally, për shkak të karakterit të egër të zonës dhe rrugëve gjarpëruese malore.
Eksplorim shpellash		Duke qenë se në zonë ka disa shpella interesante si ajo e Akullit dhe Eremitja në Kosharisht, aktiviteti i eksplorimit të tyre, është një ndër më interesantët që zhvillohet.
Kulinari/gastronomi		Gatesat interesante të zonës, bulmeti, si edhe mjalti i cilësisë së lartë paraqesin potencialin e duhur për tërheqjen e vizitorëve të kulinarisë.
4864400	Det.Prap. Investime				
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH				
4864600	Mallra				
4864900	Det.Prap.Te Tjera				
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore				
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet				
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal				
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera				
4864901	Paga				
4864902	Shpronesime				
4864903	Trans.indiv				
4864904	Trans.Subjektet				
III	Totali (I+II)	0	1,520,936	0.00%	

Detyriet për periudhen Janar – Gusht 2025 janë 0 lekë.

Punoi:

P/Sektori Buxhetit

Emanuela Çekrezi



Miratoi

Dr. Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social

Albana Hoxha



Adresa: Sheshi "Gjorg Golemi"

email: bashkiaibrazhd.gov.al

info@bashkiaibrazhd.gov.al

DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

"MONITORIMI I TË ARDHURAVE VENDORE PËR 8-MUJORIN 2025 TË BASHKISË LIBRAZHË"

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 " Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH " Ligjit nr. 68/2017 " Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" ligji nr. 9632 , datë 30.10.2006 " Për Sistemin e Taksave Vendore " Ligji 9920 datë 19.05.2008 " Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë " . VKB. nr .100 . datë 27.11.2024 " Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Librazhd për vitin 2025 . është përgatitur analiza e detajuar dhe është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur puna e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore për vitin 2025 . Planifikimi i Buxhetit për periudhën 2025, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.108, datë 27.12.2024 " Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 08/1 Prot , datë 15.01.2025.

Zbatimi i ligjeve , vendimeve , udhëzimeve , si dhe bashkëpunimi me të gjitha zyrat e tjera të administratës ka bërë të mundur realizimin e të ardhurave për 8-mujorin 2025.Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dhe dërguar zyrtarisht në afatin ligjor të përcaktuar në paketën fiskale 2025 , akt detyrimet dhe njoftim vlerësimet për gjithë subjektet e biznesit madh , vogël , institucionet shtetërore dhe jo shtetërore , ambulante ,OJF , familjaret , pronarët për ndërtesat dhënë ose jo me qera etj , në rrugë postare , elektronike e-maile etj. për të bërë të mundur njoftimin në kohë të gjithë subjekteve për detyrimet që kanë ndaj Bashkisë Librazhd për taksa e tarifa vendore .

Planifikimi për vitin 2025 është 44,879. 000 lekë më shumë se plani i vitit 2024.

Nr	Emërtimi	Plani për vitin 2024 ne leke	Plani për vitin 2025 ne leke	Rritja 2025 /ne leke
1	Të ardhura të planifikuara	175,506,000	220,385,000	44,879,000

Planifikimi për 8- mujorin e vitit 2025 është 38,194,566 lekë më shumë se plani i 8- mujorit 2024. Duke bërë krahasimet e katërmujorit të parë 2025 me të njëjtën periudhë të vitit 2024 rezulton se:

Nr	Emërtimi	Plani 8 - Mujori 2024 lekë	Plani 8- Mujori 2025 lekë	Rritja në 2025 në lekë
1	Të ardhura të realizuara	115,475,000	153,669,566	38,194,566

Periudha	Plani / lekë	Fakti / lekë	Diferenca mos realizim / lekë	Realizuar ne %
----------	--------------	--------------	-------------------------------	----------------

8-Mujori 2025	153.669.566	90.310.877	63.358.689	59 %
8-Mujori 2024	115.475.000	108.710.000	6.765.000	94 %

Duke krahasuar të ardhurat e vitit 2025 me të ardhurat me vitin 2024 shihet ulje në vlerën 18.388.123 lekë më pak se viti 2024. Kjo shihet te treguesit fiskale që zënë peshën kryesore si lejet e ndërtimit, legalizimet, një planifikim i lartë dhe mos realizim, taksa mbi ndërtesën, hapësira publike, tarifën e pastrimit, tarifën në sektorin e pyjeve kullotave, dhe në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura në qerdhe e kopshte.

Tabela e realizimit e të ardhurave nga biznesi i madh, biznesi i vogël, ndërtesat me qera, institucione shtetërore, jo shtetërore, legalizimet, ambulantë, familjarë për vitet 2024, 2025 është si më poshtë:

(Tabela nr. 1) MONITORIMI I TË ARDHURAVE TË 8 MUJORIT 2025 DHE KRÄHASIMI ME 8 MUJORIN 2024 në lekë

	Lloji i Takses, Tarifës	Plani 8-Mujori 2024	Fakti 8-Mujori 2024	Diferenca 2024	Plani 8-Mujori 2025	Fakti 8-Mujori 2025	Diferenca 2025	F
	<i>Te ardhura tatimore</i>							
	<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>							
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogel	208.000	206.000	(2.000)	232.000	135.413	(96.587)	5
2	Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale	6.400.000	5.174.000	(1.226.000)	8.000.000	6.256.759	(1.743.241)	7
3	Taksa mbi ndërtesat	9.280.000	7.254.000	(2.026.000)	10.164.500	4.907.444	(5.257.056)	4
4	Takse mbi truallin	400.000	349.000	(51.000)	455.650	407.277	(48.373)	8
5	Takse toke bujqesore	3.698.000	1.860.000	(1.838.000)	3.704.000	1.512.051	(2.191.949)	4
6	Taksa e kalim te drejtes se pronesisë	120.000	276.000	156.000	166.400	2.000	(164.400)	1
7	Taksa e ndikimit ne infrastruktura ndertimet e reja	6.800.000	9.023.000	2.223.000	14.020.000	4.693.922	(9.326.078)	3
8	Taksa e ndikimit ne infrastruktura nga legalizimet	1.880.000	950.000	(930.000)	10.515.000	1.609.745	(8.905.255)	
9	Takse table	230.000	485.000	255.000	350.500	450.150	99.650	
10	Takse hoteli	110.000	37.000	(73.000)	245.350	119.910	(125.440)	
11	Taksa e regjistrimit pervitshem te automjeteve	9.328.000	10.442.000	1.114.000	10.515.000	11.508.754	993.754	
12	Takse nga Renta	240.000	30.000	(210.000)	105.150	52.691	(52.459)	
	Shuma	38.694.000	36.086.000	(2.608.000)	58.473.550	31.656.116	(26.817.434)	
	<i>Te ardhura jo tatimore</i>							
	<i>Te ardhura nga tarifet vendore</i>							

1	Tarife pastrimi	12,900.000	15,722.000	2,822.000	16,123.000	10,184.467	(5,938,533)	63
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	2,300.000	2,103.000	(197.000)	2,593.700	1,201,161	(1,392,539)	46
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	90.000	-	(90.000)	133.190	-	(133,190)	-
4	Tarifa e sherbimit veterinar	230.000	350.000	120.000	210.300	-	(210,300)	-
5	Tarife e tregut te organizuar	800.000	682.000	(118.000)	911.300	687,410	(223,890)	71
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	24.000	12.000	(12.000)	27,339	11,000	(16,339)	41
7	Tarife parkimi	880.000	757.000	(123.000)	948,453	748,608	(199,845)	71
8	Tarife per dhenie license e certificate transporti	432.000	345.000	(87.000)	217,310	340,100	122,790	11
9	Tarife per leje te drejta, vertetime, informacione	98.000	52.000	(46.000)	140,200	86,900	(53,300)	61
10	Tarife per zenien e hapsires publike	1,350.000	809.000	(541.000)	1,504.000	503,280	(1,000,720)	31
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	90.000	13.000	(77.000)	70,100	75,000	4,900	11
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet	2,000.000	1,600.000	(400.000)	1,990.000	1,400.000	(590.000)	-
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	1,120.000	470.000	(650.000)	2,103.000	891,952	(1,211,048)	-
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	240.000	300.000	60.000	301,430	300.000	(1,430)	-
15	Tarife per mbetjet inerte	10.000	-	(10.000)	10,515	20.000	9,485	-
16	Tarifa per ndikimin ne mjedis	4,740.000	4,862.000	122.000	5,105,383	3,456,320	(1,649,063)	-
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	64.000	107.000	43.000	84,120	24.000	(60,120)	-
18	Interesa kamatvonesat	980.000	490.000	(490.000)	701.000	436,236	(264,764)	-
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	12,700.000	6,130.000	(6,570.000)	13,739,600	9,619,122	(4,120,478)	-
	Shuma	41,048.000	34,804.000	(6,244.000)	46,913,940	29,985,556	(16,928,384)	
	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave							
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	15,200.000	9,040.000	(6,160.000)	19,628.000	13,864,947	(5,763,053)	-
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	230.000	800.000	570.000	560.800	-	(560,800)	-
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	6,640.000	3,653.000	(2,987.000)	13,248.900	5,162,789	(8,086,111)	-
4	Nga shfrytezimi i druve te zjarrit nga fshataresia	3,700.000	922.000	(2,778.000)	3,505.000	692,811	(2,812,189)	-

5	Nga shfrytezimi i prodhimeve te dyta pylore, te tjera .	200.000	95.000	(105.000)	210.300	2.100	(208.200)	1
6	Te ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit dok. Ankandi rap teknik etj	408.000	136.000	(272.000)	350.500	142.261	(208.239)	4
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	128.000	-	(128.000)	140.200	-	(140.200)	-
	Shuma	26.506.000	14.646.000	(11.860.000)	37.643.700	19.864.908	(17.778.792)	5
	Te ardhura te tjera							
1	Qera e shitje trualli	-	-	-	39.176	-	(39.176)	-
2	Qera ndertese	307.000	299.000	(8.000)	490.896	311.232	(179.664)	6
3	Pagesa e prinderve cerdhe	1.456.000	1.087.000	(369.000)	2.246.800	1.072.304	(1.174.496)	4
4	Pagesa e prinderve kopesht	5.160.000	3.586.000	(1.574.000)	5.803.792	4.200.138	(1.603.654)	-
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet cerdhe dhe qendra ditore	1.232.000	-	(1.232.000)	1.016.982	-	(1.016.982)	-
6	Gjoha nga I.M.T. Policia	1.040.000	41.000	(999.000)	1.022.190	430.500	(591.690)	-
7	Te ardhura nga pullat e gjendies civile 5 %	32.000	16.000	(16.000)	18.540	11.280	(7.260)	-
8	Sponsorizime	-	18.145.000	18.145.000	-	2.618.843	2.618.843	
9	Te ardhurat nga shitja ,tarifa akte administrative	-	-	-	-	33.440	33.440	
10	Sekuestrime e zhdemtime	-	-	-	-	126.560	126.560	
	Shuma	9.227.000	23.174.000	13.947.000	10.638.376	8.804.297	(1.834.079)	
	TOTALI	115.475.000	108.710.000	(6.765.000)	153.669.566	90.310.877	(63.358.689)	

Sipas tabelës nr.1 . për 8- mujorin 2025 realizimi i'të ardhurave nga taksat dhe i tarifat vendore janë:

Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar në masën 54%

Të ardhurat nga tarifatat vendore janë realizuar në masën 64 %

Të ardhurat nga sektori i pyjeve dhe kullotave, janë realizuar në masën 53 %

Të ardhura të tjera janë realizuar në masën 83%.

Në total realizimi është 59 % .

Sipas Tabeles nr. 1 po japim shpjegimet për çdo realizim , mos realizim të planit të të ardhurave dhe realizimin në përqindje , sipas sugjerimeve dhe rekomandimeve të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe konkretisht :

Taksat janë realizuar si më poshtë :

TAKSAT

- Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin është realizuar në masën 58% e planit. Kjo për arsye se nuk disponohet informacion i saktë nga DPTI.
- Taksa mbi të ardhurat personale është realizuar masën 78% e planit. Vlerë e cila xhirohet nga Ministria 2% e vlerës që i kalojnë bashkisë, vlerë e cila nuk bëhet e mundur çdo muaj.
- Taksa e ndërtesës është realizuar masën 48 % e planit. Në regjistrin e taksapaguesve kemi shtuar shumë bazën e taksueshme sipas VKM Nr. 132, datë 07.03.2018 "Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme " ndërtesë" .. Subjektet taksapaguese taksën e ndërtesës e paguajnë detyrimin bashkë me tarifat e tjera. Për taksën e ndërtesës është punuar intensivisht me grupet e terrenit për objektet që janë legalizuar dhe ato të paidentifikuara. Është bërë një punë e madhe në informimin e subjekteve, familjarëve për taksën e ndërtesës dhe interesi ka qënë i madh për të saktësuar llojin dhe sipërfaqën për taksim. Gjithashtu është dorëzuar nga drejtoria e Taksave Vendore në 6 Njësiti Administrative rregjistri i tatimpaguesve familjarëve dhe i gjendjes civile për çdo familje, ku identifikimi i ndërtesave dhe informacioni nuk ka qënë i plotë, si proces është në vazhdim. Ky regjistër për tatimpaguesit familjare i kodifikuar është një ndihmë në identifikimin e çdo familje për çdo taksë e tarife. Është shtuar baza e taksueshme si në familjet në qytet ashtu dhe në njësiti administrative.
- Taksë mbi truallin është realizuar në masën 89% e planit. Kjo taksë është për truallin funksional përjashtuar truallin njollë nën ndërtesë.
- Taksë tokë bujqësore është realizuar në masën 41% (administruar dhe instaluar rregjistri i tatimpaguesve për çdo familje). Mos realizimi i taksës së tokës bujqësore vjen nga lëvizja e popullsisë nga një qytet në tjetrin, vështirësitë financiare. Specialisteve të Njësive Administrative ju është dhënë ndihma e duhur e qartësuar ligjet VKM për të gjetur zbatim sa më të saktë në llogaritjen e taksave dhe të tarifave.
- Kalim drejte pronësie kemi mosrealizim të planit. Nuk ka patuar asnjë shitje nga subjektet juridike, planifikimi është bërë mbi numrin e njësive pronësore që janë për transaksion për tu shitur nga subjektet juridike firmat e ndërtimit, numri i pasurive të subjekteve të ndërtimit është marrë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndërtimet e reja është realizuar në masën 33% e planit (sektori urbanistikë).

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë legalizimet mos realizim të planit. Për arkëtimin e kësaj takse janë marrë masat e duhura, si njoftim zyrtar për çdo legalizim janë afishuar listat emërore të subjekteve /personave debitore, pranë Bashkisë Librazhd për ti vënë në dijeni në lidhje për taksën e ndikimit në infrastrukturë pamvarësisht se ka ndryshim të bazës ligjore. Ligji Nr. 98/2020 datë 23.07.2020. (për çertifikimin e pronësisë nuk është e detyruar pagesa e taksës së infrastrukturës).
- Taksa e tabelës është realizuar në masën mbi njëqindpërqind e planit pasi subjektet e bankave i kanë paguar njëherësh me taksat vendore. Taksë tablele paguajnë institucionet dhe subjektet private sipas ligjit dhe sipërfaqes që ata kanë, verifikuar kjo nga komisioni i ngritur për matjen e tabelave, reklamave të ndryshme, sipas urdhërit Nr 45, datë 15.01.2025.
- Taksa hoteli është realizuar në masën 49% e planit. Tek subjektet që kanë si aktivitet hoteleri janë marrë për bazë rregjistrat e një viti më parë në planifikim ku janë të deklaruar numri i personave dhe është bërë taksimi për vitin aktual.
- Taksa e regjistrimit të mjeteve është realizuar mbi 100 % e planit, për një planifikim më të saktë po punohet në një database për të gjitha mjetet që janë në Bashkinë Librazhd në bashkëpunim me DSHPRR-në.
- Të ardhura nga Renta, është realizuar në masën 50% nga subjektet minerare që janë në juridiksionin e Bashkisë Librazhd, taksë e cila xhirohet nga drejtoria e tatimeve dhe dogana.

Pra sa më lart realizimi nga taksat vendore është në masën 54 %

TARIFAT

- Tarifa e pastrimit është realizuar në masën 63 % . Për shërbimin e dhënë nga bashkia si për familjarët ashtu edhe subjektet private, institucionet është bërë një punë shumë e madhe në informimin dhe në sensibilizimin, efektin për pagesat e kryera nga ana e tyre dhe ndikimi në mjedis që i shërben komunitetit në mirqënie dhe në mbajtjen pastër të qytetit. Janë informuar bizneset në njësitë administrative për tarifën e pastrimit janë paisur me kosha dhe ndërgjegjësuar për pagesën e kësaj tarife. Sipas paketës fiskale për Njësitë Administrative ka diferencim çmimi nga qyteti. Janë shtuar bizneset që ushtrojnë aktivitetin në Bashkinë Librazhd që marrin shërbimin e pastrimit.
- Tarifë ndriçim gjelbërimi është realizuar në masën 46% pasi lidhet me afatin e likuidimit të taksave dhe të tarifave vendore si dhe të tarifave familjare.

- Tarifë shërbimi në varrezat publike nuk është realizuar nga subjektet që kryejnë shërbime funerale pasi bëhet pagesa menjëherë me taksat e tjera në afatin ligjor të kryerjes së pagesave.
- Tarifën e shërbimit veterinar nuk është realizuar plani. Këtë tarifë e paguan subjekti i thertores sipas numrit të krereve të imta dhe të trashë të cilat mbahen në një regjistër të veçantë dhe në Bashkinë Librazhd është një subjekt që ushtron aktivitetet e tillë. Tarifimi është i sakte, informimi për numrin e krereve të imta dhe të trasha është marrë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Veterinar Elbasan, e cila e ka detyrim ligjor për informim.
- Tarifë e tregut të organizuar realizuar në masën 75 % sipas kontratave, arkëtime nga biletat ditore. Për vitin 2025 janë lidhur 23 kontrata me tregtarët në tregun e qytetit nga 21 në vitin 2024. Janë sistemuar të gjithë tregtarët ambulantë brenda në treg dhe taksimi sipas percaktimeve dhe tarifave të miratuara në Këshillin Bashkiak. Krahësuar me një vit më parë kemi pothuajse në ato nivele të numrit të kontratave të tregtarëve në tregun e qytetit, gjë e cila ka ndikuar jo pozitivisht në të ardhurat që vijnë nga tregu. Për tregtarët ditore kërkohet një përgjegjëshmëri më e mirë nga Policia Bashkiake për funksionimin sa më të mirë të tregtareve të produkteve brenda tregut të qytetit.
- Tarifë parkimi është realizuar në masën 79 % e planit, sipas paketës fiskale me marrjen e licensës, certifikatës së transportit paguajnë dhe tarife parkimi të cilët kanë të regjistruar në QKB sipas numrit dhe targës së mjetit.
- Tarifë për dhënie liçense e certifikate transporti është realizuar në masën mbi njëqindpërqind e planit. Subjektet e transportit rreth qytetas paisen nga bashkia me liçense e certifikatë transporti. Të gjitha subjektet private që janë paisur me liçensë nga bashkia janë miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe konfirmuar në Prefekturën e qarkut Elbasan. Në Liçensën që marrin subjektet nga Bashkia janë të përcaktuara linjat dhe oraret për linjat rrethqytetase të miratuara në VKB dhe në Qark. Janë futur në regjistrin e biznesit të gjitha subjektet e licensuara. Çdo subjekt që liçensohet nga Bashkia në momentin e marrjes së saj plotëson të gjithë dokumentacionin e duhur të fotokopjuara dhe të noterizuara të cilat ruhen bashkëlidhur liçensës ose certifikatës së transportit. Aktualisht janë të miratuara 42 linja rrethqytetase dhe 42 subjekte për 6 njësitë administrative me orarë kthimi e nisje të përcaktuara dhe 5 subjekte të linjave ndërqytetase. Subjektet e linjave ndërqytetase të cilat liçensohen nga Ministria janë: Sefa Trans, Megi 2001 shpk, Haka shpk, Prodani, Kampula.

- Tarifë për leje të drejta . Vërtetimi . informacione është realizuar në masën 62%.Tarifë nga vërtetimet paguhet nga individet për kolaudim dhe subjekte biznesi. si vërtetim per detyrime ose jo . ushtrim aktiviteti ose jo . Vërtetimi për invajdet . ndihmë ekonomike jepet pa pagesë nuk e paguajne shërbimin kjo në zbatim të pakës fiskale 2025.
- Tarifa për zënien e hapësirave publike është realizuar në masën 33 % . Për hapësirat janë mbajtur konstatime nga grupi i ngritur sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr .43, date 15.01.2025 në cdo biznes . janë nënshkruar kontrata . planimetri e përgatitura nga inxhinieri (nuk jane përgatitur per vitin 2025) e plotësuar detyrimi për shfrytëzimin e hapësirës publike .Tarifën për zënien e hapësirës publike e paguajnë në momentin që paguajnë taksat e tarifave të tjera dhe kjo lidhet me afatin e pagesës .Për vitin 2025 janë konstatuar 36 subjekte që shfrytëzojnë hapësirë publike (18 janë në zonen pedonale me sipërfaqe 701.9 m2 ne vleren 1.685 mije leke . dhe 18 ne zonen jashte pedonale me sipërfaqe 585.7 m2 ne vleren 646 mije leke) .
- Tarifë për librat e udhëtimit të udhëtarëve brenda vendit është realizuar në masën 107 %.Librat e udhëtimit merren me kërkesen e subjekteve të transportit për linjat rrethqytetase të cilët i përdorin kur dalin jashtë linjave të përcaktuara në licensë e çertifikatë transporti.
- Tarifë për autorizime . ushtrim aktiviteti . autorizime për karburantet është realizuar në masën 70% ku subjekti i karburantit paiset me autorizim për ushtrimin e aktivitetit te tij . Subjektet e karburantit paisen me autorizim nga bashkia për funksionimin e aktivitetit të karburantit referuar Vendimit Keshillit Ministrave Nr 344 . date 19.04.2017.
- Tarifë nga urbanistika është realizuar në masën 42 % e planit (sektori i urbanistikes) .
- Tarifë për linjat ajrore e nëntokësore është realizuar në masën njëqindpërqind e planit . Këtë tarifë e paguajnë subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e transmetimit televizive . internet . kabllorë . fibra optike . Janë marrë të dhëna tek AKEPI dhe AMA për numrin e abonenteve që ka secili subjekt privat i regjistruar dhe është vendosur tarifa .Në Bashkinë Librazhd janë 4 subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e transmetimit televizive . internet kabllor etj .
- Tarifë për mbetjet inerte është realizuar në masën njëqindpërqind e planit . Janë subjekte që kryejnë punime e transportojnë mbetje inerte në venddepozitimet e përcaktuara me VKB .Kjo tarife realizohet ne bashkëpunim nga IMT dhe Policia Bashkiake. Kemi tejkalim te planit pasi jane shtuar kontratat e subjekteve qe kryejne punime për shpenzime dhe investime për periudha te shkurtra kohe .

• **Tarifa për ndikimin në mjedis është realizuar në masën 68% e planit . tarifë e cila paguhet nga**

subjektet minerare , subjektet e prodhimit të energjisë dhe karourantët .

- Tarifat e shërbimit nga struktura e mbrojtjes nga zjarri e shpëtimiti (të ardhurat nga MZSH) janë realizuar në masën 29 % e planit (sektori MZSH).
- Gjambat(interesa kamatë vonesat) janë realizuar mbi 62 % e planit . janë llogaritur sipas ligjit në fuqi mbas afatit zyrtar llog 0.06 % në ditë mbi detyrimin deri më 365 ditë, dhe për kontratat e lidhura me subjektet ashtu si përcaktohet 0.01 % në ditë .Nje pjese e mire e taksapaguesve jane ndergjegjesuar per likuidimin ne kohe te detyrimit . ku prej vitesh është bërë një punë e mirë në informimin dhe afatet e likuidimit të detyrimit që kanë taksapaguesit .
- Detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tartifat janë realizuar në masën 70% e planit . kjo në zbatim të Ligji Nr. 9920 datë 19.05.1998 " Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë "si njoftim vlerësimet , bllokimet e llogarive bankare , mase sigurie mjeti , vendosje mase së bllokimit të pasurisë në qkb. vendosje mase sekuestro në hipoteke etj . janë arkëtuar detyrimet nga subjektet të palicensuara dhe nje pjese e mirë e bizneseve janë ndergjegjesuar për detyrimet . si dhe për taksën e ndikimit në infrastrukturë /legalizimet janë arkëtuar nga familjarët detyrimet e prapambetura të xhiruara nga ujësjellësi mbas njoftimit për pagesë të dërguar nga Drejtoria e Taksave Vendore . për detyrimin ndaj Bashkisë. Detyrimet e prapambetura që janë ndërvite është shumë e vështirë për tu arkëtuar pasi shumë biznese nuk ju gjendet as adresë as kontakte dhe nuk jane fizikisht në aktivitet (janë debitore pa shpresë arkëtimi).

Pra sa më lart realizimi nga tarifat vendore është në masën 64 %

Realizimi nga tarifat vendore ne sektorin e pyjeve dhe kullotave

- Të ardhurat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave është realizuar në masën 53% e planit që ka të bëjë tarifat në sektorin pyjor , kullosor , prodhimet e dyta . të ardhura nga rrallimet si dhe me kontratat e lidhura me subjektet dhe bashkinë për shfrytëzimin e materialit drusor (Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave) .

Të ardhura të tjera jo tatimore

- Qera e shitje truallit nuk ka planifikim (drejtoria e buxhetit dhe finances).
- Qera ndërtesë është realizuar 63% e planit ku janë kontrata të lidhura me Bashkinë dhe familjarët (privatizimi i banesave) . (drejtoria e buxhetit dhe finances)
- Pagesat e prindërve për çerdhe është realizuar 48% (drejtoria e buxhetit dhe financës) .
- Pagesat e prindërve për kopësht është realizuar 72 % e planit (drejtoria e buxhetit dhe financës).
- Detyrimet e prapambetura çerdhe, kopësht, qendra ditore nuk është realizuar plani. (drejtoria e buxhetit dhe financës) .

- Gjoha nga IMT dhe Policia është realizuar në masën 42% e planit (Policia Bashkiake, IMT)
 - Të ardhura nga pullat janë realizuar në masën 61 % e planit.
- Në total realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është 59 %.**

Paraqitja e numrit të bizneseve në 8- mujorin e vitit 2025

Për sa i përket numrit të subjekteve / bizneseve nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën 2024 dhe 31.08.2025 subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë.

Lloji i Biznesit	Paraqitja e numrit te bizneseve			Gjendja më 31.08.2025
	Gjendja më 31.12.2024	Biznese të reja 8- mujori viti 2025	Biznese të mbyllura, pezulluara 8- mujori viti 2025	
Biznesi Vogël	661	26	21	666
Biznesi Madh	149	7	10	146
Institucione	36	2	0	38
Gjithsej	846	35	31	850

Biznese të hapura në 8- mujorin viti 2025 janë:

- Biznesi madh
 - 1- Pe-Vla -Ku
 - 2- ADM International
 - 3- Grein –T shpk
 - 4- Zeqillari Shpk
 - 5- Caushi M Shpk
 - 6- Apis Construction Shpk
 - 7- Çota shpk

- Institucioni
 - ISSH (institucion)
 - Alb Natyra fondacion

- Biznesi vogel 26 subjekte

Biznese të mbyllura nga biznesi madh janë:

- 1- Afrim Zeneli
- 2- Mineral – Unit
- 3- Eduart Gjura
- 4- Alb – Buldig
- 5- K.M.K
- 6- L.T.E
- 7- Resort Ballkan
- 8- Ogier Shpk
- 9- 2A Agim Sula
- 10- Rosi Construction "Shefki Doma "

- Biznesi vogël 21 subjekte të mbyllura .

Për bizneset e pezulluara nga Drejtoria e Taksave Vendore janë marre masat për verifikimin në terren për ushtrim ose jo aktiviteti privat dhe në rast se kostatohen raste mbahet konstatime dhe taksohen e tarifohen

sipas llojit të aktivitetit dhe dërgohet njoftim DRTT Elbasan . Për Periudhen Janar – Gusht 2025 janë konstatuar 66 subjekte të palicensuara në qytet (nga këto 22 janë të reja) ,për rregjistrimin dhe çertifikimin është njoftuar Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Elbasan me shkresë zyrtare Nr.1967 Prot . datë 08.04.2025.

Gjendja e bizneseve aktive deri më 31.08.2025 janë 850 subjekte .

Është punuar dhe vazhdon puna në terren për identifikimin dhe informalizimin e bizneseve duke i orientuar dhe duke i futur në rregjistrin e biznesit të Bashkisë . Taksimi dhe tarifimi është bërë mbi bazen e prgjegjesise tatimore të miratuar në Paketën Fiskale . Gjithashtu dhe bashkëpunimi me Policinë Bashkiake ka qënë një ndihmë për kordinimin dhe për ecurinë e punës si në lidhje me subjektet e palicensuara , tregtarët ambulatorë ,sistemimin e tregtarëve në tregun e qytetit.

Për sa i përket tarifës së hapësirave publike për vitin 2025 janë planifikuar 2.260.000 leke .në katër zona, ku dhe tarifimi i tyre ndryshon sipas zonave miratuar në paketën fiskale të vitit aktual.

Në zonën A pedonale kemi 18 subjekte biznesi që shfrytëzojnë hapësirë publike.

Në zonën B , C, Ç kemi 17 subjekte biznesi që shfrytëzojnë hapësirë publike .

Për sa i përket taksës së tabelës për vitin 2025 janë planifikuar 500.000 leke . sip është 48.4 m2 per 10 subjekte biznesi ,si banka , fondacione .

Për sa i përket taksës së hotelerisë për vitin 2025 janë planifikuar 350.000 lekë me një numër 8 subjekte biznesi.

Për objektet e legalizuara .

Për të gjitha dosjet e ardhura nga aluizni (ASHK) janë bërë llogaritjet për çdo m2 sipërfaqe , për çdo pronar ku ndodhet pasuria e lloji i pasurisë dhe numri i objektit që legalizon.Numri total i objekteve të legalizuara për 8- mujorin e vitit 2025 nga ASHK Elbasan, kanë ardhur 92 dosje objekte të legalizuara me vlerë të llogaritur 3.327 mijë lekë .Në 8- mujorin e vitit 2025 janë arkëtuar / paguar 58 dosje objekte legalizimi me vlerë 1.610 mijë lekë sipas % e llojit të ndërtesës përcaktuar me VKM e VKB .

/000 lekë

Nr	Gjendja me 31.12.2024		Dosje të hyra Janar – Gusht 2025		Pagesa të kryera Janar – Gusht 2025		Gjendje me 31.08.2025 Subjekte debitoare	
	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000	Nr dosje	Vlera /000
2	174	8,377	92	3,327	58	1,610	206	10,047

2 dosje legalizimi me vlerën 47mije leke janë të bashkisë Prrenjas dhe vlera debitoare deri 31.08.2025 është 10.047mije leke. Për vlerën debitoare është bërë një punë e mirë me njoftimin e subjekteve si në rrugë zyrtare , telefon e-mail e fizikisht në objekt etj , janë afishuar listat e debitorëve pranë Bashkisë dhe ASHK –së. Në ASHK , aktin /çertifikatën e pronësisë pronarët i terheqin dhe pa e paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë të legalizimit të cilën nuk e pengon pronarin të tërheqë çertifikatën e pronësisë

nga ndryshimi i ligjit 9632 date 30.10.2006 me Ligjin 98/ 2020. Pamvarësisht masave që janë marrë si njoftim për pagesë në momentin që vjen dosja e legalizimit në bashki . njoftim vlerësimi etj ,mbeten detyrime te konsiderueshme për të arkëtuar .

Është plotësuar e përmirësuar rregjistri elektronik i biznesit me të dhënat përkatëse duke marrë informacion nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Elbasan për llojin e biznesit ,i madh, i vogel . vazhdon plotësimi me të dhënat ID ,çertifikatë rregjistrimin e QKB , çertifikatë pronësie , kontratë qeraje etj.

Është bërë një punë e mirë në lidhje me disa biznese të mëdha që prej vitesh ishin debitore dhe sot janë në vijueshmëri të mirë me pagesat që kryhen nga ana e tyre .duke lidhur dhe marrëveshje për pagesë me këtë në zbatim të ligjit 9920, datë 19.05.2008 " Për Procedurat tatimore në RSH".

Një numër i konsiderueshëm nga debitorët familjarë janë ndërgjegjësuar dhe kanë arkëtuar detyrimet e prapambetura që kanë ndaj Bashkisë për taksa e tarifa vendore . Njëkohësisht me familjarët po bashkëpunohet për të saktësuar sipërfaqen e ndërtesës me dorëzimin e çertifikatës së pronësisë dhe verifikimi në terren i ndërtesave aty ku lind e nevojshme ose informacioni nuk është i saktë .

Vlen të përmendet se Sistemi i Kadastres Fiskale ka qënë një ndihmë shumë e madhe në verifikimin e të dhënave për çdo pronar të ndërtesave dhe taksimin e tyre , por aktualisht nuk është i aksesueshem . Nga Drejtoria e Pergjithshme e Taksës së Pasurisë, është shumë e domosdoshme që të kryhen trajnime për ngritjen profesionale të punonjësve si në bashki të drejtorisë së taksave ashtu dhe të punonjësve të taksave në gjashtë Njësitë Administrative .

Në programin e instaluar (sistemin e taksave ,hidhen çdo dite të dhëna të sipërfaqeve të ndërtesave , përditësohen të dhënat në rast transaksioni të pasurive , hidhen te dhëna qe merren nga ASHK, ALUIZNI,Gjendje Civile , OSHEE, verifikimi në terren etj.Qëllimi i hedhjes se ketyre te dhenave është identifikimi , regjistrimi i çdo sipërfaqe ndërtese e cila ndikon në ritjen dhe zgjerimin e bazës së taksueshme .Në kuadër të bashkëpunimit me projektin Bashki të Forta kemi bërë të mundur realizimin e regjistrit unik dhe te kodifikuar për familjarët në 6 Njesitë Administrative si dhe marrja e informacionit në bazë të gjendjes civile për gjendjen familjare për të gjithë Bashkinë me të dhëna si kryefamiljari ,nr i personave ,datëlindja ,adresa , nr tel etj.

Taksat e Tarifat Vendore për familjarët në qytet mblidhen nëpërmjet Shoqërise Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan

Për vitin 2025 është përgatitur kontrata (akt marrëveshja) me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan ,si agjent tatimor për arkëtimin e taksave e tarifave vendore për abonentet familjarë së bashku me faturën e ujit pijshëm.

Për vjeljen e detyrimeve familjare për vitin 2025 për taksa e tarifa vendore janë përgatitur listat dhe janë dërguar tek agjenti tatimor sipas VKB. Nr. 30 datë 26.03.2025 " Për caktim Agjenti Tatimor për Vitin 2025 " dhe konfirmim akti Nr.453/1 Prot . datë 07.04.2025 nga Prefekti i Qarkut Elbasan . Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Elbasan . sipas akt marreveshjes së lidhur me shkresë të Bashkisë Librazhd . Nr .2194 Prot .datë 23.04.2025 e shkresa me Nr. 730 Prot. datë 22.04.2025 të Shoqërisë Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Elbasan. me nr 2562 familje me vlerë 7.794.459 lekë .Taksat e tarifave vendore familjare do te vilen për një periudhë 4 mujore sipas marrëveshjes mes palëve . Detyrimet për taksa e tarifa vendore për familjarët i kemi sistemuar dhe llogaritur sipas Paketës Fiskale dhe Ligjit në fuqi dhe statusit të çdo kryefamiljari .

Debitorë familjarë në qytet për taksa e tarifa vendore deri më 01.01.2025 janë 1,800,938 lekë të pa vjela + detyrimi 4,282.139 detyrim për tu xhiruar i arkëtuar = 6,083,077 lekë . Detyrimi i vitit 2025 është në vlerën 7.794.459 lekë. pagesa të kryera në vlerën 1,000,000 lekë. Detyrimi total 12,877,536 lekë nga këto 6.659.862 janë të arkëtuar dhe të pa xhiruara në llogari të Bashkis Librazhd . (sipas rakordimit 31.08.2025).

Nga Shoqëria Ujësjetlës Kanalizime nuk bëhet xhirimi i shumës së arkëtuar nga ana e tyre cdo muaj sipas marrëveshjes së nënshkruar midis palëve . Detyrimin që ka Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime ndaj Bashkisë Librazhd me 31.08.2025 është 12,877,536 leke. Taksat e tarifave vendore për familjarët në qytet vilen për një periudhë 4 mujore (sipas marreveshjes Qershor -Shtator) .

Në lidhje me debitorët për taksa e tarifa vendore ndër vite .

Detyrimet e prapambetura (2011-2024) ne total jane **107,748,411** lekë me nje numer total 6.507 subjekte . ku perfshihen detyrimet biznesi i madh. i vogel , ndertesat per veprimtari ekonomike dhe me qera. legalizimet .ambulante . debitorët familjare te 6 Njesite Administrative . familjaret në qytet.

Në total debitorët biznesi vogël . madh ambulantë . ndërtesa *social ekonomik* , me qera (2011-2024) mbetje më 31.12.2024 subjekte debitore me Nr. 476 ne vleren 48,745.650 leke jane paguar 9,619.123 leke .

Bizneset $48.745.650 - 9.619.123 = 39.126.527$ leke dhe subjekte Nr .401.

Debitorët per Legalizimet $8.377.411 - 104.775 = 8.272.636$ leke.

Debitorët per Familjaret ne qytet $1.800.938 - 220.265 = 1.580.673$ lekë për abonentët .

Shuma debitore per Familjaret ne qytet total 31.12.2024 ne vleren $6.083.077 - 4.502.404$ arkëtuar pa u xhiruar $= 1.580.673$ leke debitore . abonente pa u arkëtuar.

Debitorët familjare ne gjashte njesite administrative ne 31.12.2024 janë në vlerën **44,542,273** lekë me një numër 5.669 subjekte/familjare . Jane arkëtuar per periudhen Janar – Gusht 2025 shuma 1,901,641 leke mbeten me 31.08.2025 ne vleren 42.640.632 leke .

NR	EMËRTIMI	VLERA NË LEKË	Pagesat 8-mujori 2025	Mbeteje vlere debitore 31.08.2025
1	Biznesi madh , vogel ambulante nderresa social ekonomik eij	48.745.650	9.619.123	39.126.527
2	Debitore per objekt e Legalizimeve	8.377.411	104.775	8.272.636
3	Debitore familjare ne gytet	6.083.077	4.502.404	1.580.673
4	Debitore familjare ne njesite administrative	44.542.273	1.901.641	42.640.632
TOTALI		107,748,411	16,127,943	91,620,468

Për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura subjektive është ne vazhdim procedura e mbledhjes me force e detyrimeve ku procedura e parë është njoftim vleresimi për detyrimet e prapambetura / papaguarata për biznesin e madh, biznesin e vogel, legalizimi, tregu , nderresat.kjo në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 -- Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë " ndryshuar në neni 88 , neni 89 neni 90 neni 91.

Procedura e MSH:

- 1- Njoftim Vleresimi per biznesin e madh sipas shkrases Nr. 3539 Prot . date 25.07.2024 me listen emerore 116 biznese me vleren 36.365.475 leke . pasi afati per pagese ka gene 30.06.2024 .
 - 2- Njoftim vleresimi per biznesin e vogel , nderresa me gera , ambulante eij sipas shkrases Nr. 5790 Prot . date 25.11.2024 me listen emerore 441 biznese me vleren 23.092.200 leke . pasi afati per pagese ka gene 30.09.2024 .
 - 3- Njoftim vleresimi per objektete legalizuar sipas shkrases Nr. 4727 Prot ,date 08.10.2024 me listen emerore 197 persona .
 - 4- Njoftim Vleresimi per tregtarët qe tregtojne ne tregun e qytetit sipas shkrases Nr. 5386 Prot . date 05.11.2024 me listen emerore 106 me vleren 3.814.470 leke .
- Mbas procedures se bere si me sipër janë pergatitur Bllokimi e llogarise , urdhëra bllokimi , si me poshte :
- 1- Bllokimi llogarive bankare sipas shkrases Nr. 4402 Prot . date 24.06.2025 sipas listes emerore , me Nr 426 subjekte biznesi madh i vogel . nderresa me gera social ekonomike , ambulante eij ne vleren 39.874.445 leke . shkrases Nr. 5649 Prot . date 22.08.2025 sipas listes emerore me Nr 372 subjekte biznesi madh i vogel . nderresa me gera social ekonomike , ambulante eij ne vleren 37.445.463 leke .

2- Vendosje barre hipotekore te Pasurive sipas shkrases Nr 4404 Prot . date 24.06.2025 sipas listes emerore me Nr 426 subjekte biznesi madh I vogel . ndertesa me gera social ekonomike . ambulante eji ne vleren 39.874.445 leke.

3- Vendosje mase se bllokimit te pasurise ne QKB . sipas shkrase Nr 4403 Prot . date 24.06.2025 sipas listes emerore me Nr 426 subjekte biznesi madh I vogel . ndertesa me gera social ekonomike . ambulante eji ne vleren 39.874.445 leke.

4- Vendosje barre sigures te mjeteve te transportit . sipas shkrase Nr 4405 Prot . date 24.06.2025 sipas listes emerore me Nr 426 subjekte biznesi madh I vogel . ndertesa me gera social ekonomike . ambulante eji ne vleren 39.874.445 leke.

Theksojme faktin se shume subjekte debitore qe kanë mbetur ndër vite janë subjekte te cilet kanë mbyllur aktivitetin . janë larguar (pamvaresisht se është zbatuar dhe procedura e masave shtrënguese) kanë ndërruar jete eji . Sipas analizës së bërë për bizneset debitore ndër vite kemi bërë një ndarje si më poshtë:

Debitorë pa shpresë arketimi Nr .186 .në vlerën 25.106.272 leke

Debitorë nga 3 deri në 5 vite Nr. 32 në vlerën 2.037.708 leke

Debitorë nga 2 deri në 3 vite Nr. 183 në vlerën 11.982.547leke

Pra në total vlera debitore për subjektet e biznesit madh . vogël ambulante . ndertesa me gera eji nga 48.745.650 leke. janë paguar gjatë periudhës Janar - Gusht 2025 në vlerën 9.619.123 leke dhe mbeten 39.126.527 leke.

Për regjistrimin e ndertësive dhe taksimin e tyre krahasimi duket si më poshtë :

Për vitin 2025 . grupet e ngritura sipas shkrases Nr 253. Prot . date 15.01.2025 . me urdher Nr. 42 date 15.01.2025 . te titullarit te Bashkise " Per verifikimin e Informacionit ne terren per Popullimin e Kadastres Fiskale . janë bërë regjistrimet e tyre ne regjistrin e biznesit dhe te familjeve . Kemi një shtrirje me te madhe te bazës se taksueshme . krahasuar me vitin 2024.

Sistemi i Kadastres Fiskale është një ndihmë shume e madhe ne verifikimin e te dhënave per cdo pronar te ndertësive dhe taksimin e tyre . (procesi aktualisht nuk aksesohet) Nga Drejtoria e Pergjithshme e Takses se Pasurise është shume e domosdoshme qe te kryhen trajnime per ngritjen profesionale te punonjësve.

Ne programin e instaluar te taksave . hidhen cdo dite te dhëna te siperfaqeve te ndertësive . përditesohen te dhënat ne rasti transaksion i te pasurive . hidhen te dhëna qe merren nga ASHK. ALUZIONI. Gjendje Civile . OSHEE. verifikimi ne terren eji. Nga verifikimet qe bëhen ne terren per ndertësar . identifikohet dhe hidhen ne regjistrin per një pjese e pronareve janë me statusin e pensionistit . ndihmes ekonomike te cilet i perjashton ligji per pagese .

Qëllimi i hedhjes së ketyre të dhënave është identifikimi , regjistrimi i cdo sipërfaqe ndërtese e cila ndikon në rritjen dhe zgjerimin e bazes së taksueshme .

Për vitin 2025 , shkalla e takses për njësi shërbimi e miratuar dhe aplikuar është 0.17 %

Për vitin 2025 në 6 njësitë administrative , shkalla e takses për njësi shërbimi e miratuar dhe aplikuar është 0.16 % .

Për vitin 2025 , shkalla e takses për banim e miratuar dhe aplikuar është 0.035%

Për vitin 2024 , shkalla e takses për njësi shërbimi e miratuar dhe aplikuar është 0.2 %

Për vitin 2024 në 6 njësitë administrative , shkalla e takses për njësi shërbimi e miratuar dhe aplikuar është 0.18 % .

Për vitin 2024 , shkalla e takses për banim e miratuar dhe aplikuar është 0.035% .

Kemi bërë të mundur realizimin e regjistrimit unik dhe të kodifikuar për familjarët në 6 njësitë administrative si dhe marrja e informacionit në bazë të gjendjes civile për gjendjen familjare për të gjithë Bashkinë me të dhëna si kryefamiljari ,nr i personave ,datelindja , adresa , nr tel etj për të bërë të mundur zbatimin e VKM 132 datë 07.03.2018 " Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme " Ndërtesa " ... për vlerësimin alternativë të detyrimit të takses.

Numri I sipërfaqeve të shtuara , Njesia Administrative Qender Nr.8 me sip 652 m2, Polisi nr. 4 me sip 525 m2, Hotolishti Nr. 4 me sipërfaqe 526 m2, Lunik nr. 3 me sip 285 m2, Orenje Nr 1 me sipërfaqe 235 m2, Stebleva Nr 3 me sip 290 m2 .

Përgatitja e njoftimit detyrimit për vitin 2025.

Për periudhën Janar – Gusht 2025 nga dy sektorët e drejtorisë janë përgatitur 1112 akt detyrime të subjekteve në vlerën 65.208546 lekë dhe fatura arkëtimi shtesë me nr. 212 subjekte në vlerën 11.621.792 lekë .

Listat bashkëlidhur të firmosura nga sektorët përkatës .

Për periudhën Janar – Gusht 2025 janë përgatitur dhe dërguar në rrugë postare , email etj . akt detyrimet e subjekteve private dhe individeve , familjareve .

Për sa i përket 6 njesive administrative specialistet kanë përgatitur njoftim detyrimet e vitit 2025 dhe janë në proces të përfundimit të tyre .Njesia Ad. Qender ka shpërndarë 73 akt detyrime në rrugë zyrtare , Njesia Ad. Hotolisht 370 akt detyrime , Njesia Ad. Stebleva , Njesia Adm. Orenja njoftimet nuk janë nisur , Njesia Adm. Lunik 272 akt detyrime , Njesia Adm. Polis 402 akt detyrime .

Për tregun e qytetit .

Plani i të ardhurave për vitin 2025 është 1.300 mijë lekë ,si 8- muor i vitit 2025 plani është 911,300 leke dhe janë arkëtuar 687.410 lekë (vlera e kontrates 207.400 leke plus bileta 480,010 leke. Në vlerën e arkëtuar të kontratave janë dhe debitoret 74.100 lekë(58.800+15.300)).

Në tregun e qytetit numri i kontratave të lidhura midis tregtareve dhe bashkisë ka rritje 2 subjekte nga 21 kontrata në vitin 2024 . për vitin 2025 nr i kontratave të lidhura është 23.

Janë kryer kontrole në disa subjekte në bashkëpunimi me Policinë Bashkiake . në tregun e qytetit janë bërë sistemime , vizime ku të gjithë subjektet të tregtojnë brenda hapsirës së tregut. Policia duhet më prezente në ditet e tregut të qytetit.Më poshtë është paraqitur ecuria e pagesave te tregtareve ne qytet.

Nr	Gjendja me 31.12.2024			Ngarkesa e vitit 2025	Pagesat e kryera per 8-mujorin 2025	Sistemime per vitin 2025	Gjendja me 31.08.2025	
	Viti	Numri debitoreve	Shuma e detyrimit				Numri debitoreve	Shuma e detyrimit
1	2011	28	543.370	-	2,400	15,300	27	525,670
2	2012	24	438.200	-	-		24	438,200
3	2013	22	373.800	-	-		22	373,800
4	2014	28	385.800	-	-		28	385,800
5	2015	23	427.200	-	-		23	427,200
6	2016	22	334.800	-	-		22	334,800
7	2017	20	353.500	-	-		20	353,500
8	2018	19	289.800	-	-		19	289,800
9	2019	17	282.800	-	2,400		16	280,400
10	2020	19	171.000	-	0		19	171,000
11	2021	10	62.400	-	0		10	62,400
12	2022	9	54.000	-	4,800		6	49,200
13	2023	7	37.800	-	13,200		4	24,600
14	2024	17	43.800		36,000		2	9,000
15	2025	23	0	222,700	148,600		23	74,100
Shuma			3,798,270	222,700	207,400	15,300		3,798,870

Përsa i përket detyrimeve të prapambetura 2011-2024 për vlerën debitore 31.12.2024 shuma 3.798.270 lekë janë paguar gjatë periudhës Janar- Gusht 2025 shuma 58.800 lekë zbritur 15.300 leke me Vendim te Komisionit Apelimit Tatimor dhe mbeten detyrime të prapambetura 3.724.170 leke .

Duke shtuar planifikimin e 2025. zbritur pagesat deri me 31.08.2025 gjendja totale debitore eshte 3.798.870 leke .

Për sa i përket 6 Njësive Administrative për 8- mujorin e vitit 2025 rezulton se :

EMËRTIMI	Plan 2025	PLANI 8 - MUJORI 2025	FAKTI 8- MUJORI 2025	Mbetje	% realizimit
----------	-----------	-----------------------	----------------------	--------	--------------

Njësia Administrative Hotolisht	6.952.939	4.635.288	566.889	4.068.399	12
Njësia Administrative Lunik	1.478.040	890.920	367.100	523.820	41
Njësia Administrative Orenje	901.536	601.016	203.820	397.196	34
Njësia Administrative Polis	1.259.250	839.499	527.074	312.425	62
Njësia Administrative Stebleve	912.000	607.990	282.891	325.099	47
Njësia Administrative Qender	3.898.549	2.599.024	1.490.165	1.108.859	57
Shuma	15.402.314	10.173.737	3.437.939	6.735.798	34

Sic shikohet në tabelen e realizimit të të ardhurave në gjashtë Njësite Administrative është nivel i ulët i mbledhjes së të ardhurave. Specialistet kanë vështirësi në zbatimin e akteve ligjore (pamvarsisht se nga drejtoria është dhënë ndihma e duhur si në interpretimin e akteve ligjore, përlogaritjen e taksave, përjashtimet që jep ligji, përgatitjen e tabelave në exel, përgatitjen e llogaritjen e taksave vendore etj), vështirësitë i kanë të theksuara. Nga këto problematika informacioni që administrohet nga njësitë është jo i saktë dhe dorëzimi i informacionit nga disa specialiste jo në afatet e duhura kohore, si dhe në raportimin e të dhënave të pronësisë, përjashtimet që jep ligji për një kategori të caktuar etj janë jashtë afateve dhe në mënyrë jo korrekte dhe të jo saktë.

Me gjithë punën e kryer dhe përkushtimin që ka Drejtoria e të Ardhurave Vendore, ka mangesi problematika për tu përmirësuar e për të ecur përpara në realizimin e objektivave.

Për këtë janë identifikuar rrisqet që ndikojnë në realizimin e tyre që mund të përmendim.

Faktorin Rrisk si :

- 1- Ngritja e kapaciteteve profesionale të specialisteve të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore veçanërisht të specialistëve në gjashtë njësitë administrative.
- 2- Vështirësia e mbledhjes së taksave në zonat rurale.
- 3- Debitorët ndër vite, mundësia e mosqjetjes së adresës së subjektit debitor ndër vite
- 4- Parkimi ditor në zonat me potencial më të madh.
- 5- Ndryshimi i bazës ligjore për legalizimet.
- 6- Informalizimi i sipërfaqes së ndërtesave dhe ndryshimi i çmimit të ndërtesave që nuk janë funksion pamvarësisht nga lloji i pasurisë.
- 7- Infomalizimi i bizneseve në vazhdimësi.
- 8- Bashkëpunimi me Policinë Bashkiake.
- 9- Marrja dhe popullimi i të dhënave të pronësisë nga Kadastra Fiskale.
- 10- Pamundësia e marrjes së të dhënave të pronësisë.

HARTOI
DREJTORE E ARDHURAVE VENDORE
Lindita Shuli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ____/09/2025

“Mbështetje financiare për përballimin e fatkeqësisë së krijuar nga zjarri për bashkinë Gramsh”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, Udhezimi plotësues nr.2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/09/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare për përballimin e fatkeqësisë së krijuar nga zjarri për bashkinë Gramsh mbështetur në shkresën nr.5679 datë 25.08.2025 në vlerën 2,000,000 lekë.
2. Fondi prej 2,000,000 lekë do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2025 “Emergjencë Civile” në strukturën buxhetore si më poshtë:

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera
00	3280	01	606	2,000,000 lekë
Emergjencë civile				

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social, Sektori Financës.
